D.B. Sot është 28 prill 2003,

D.B. ...dhe koha sipas orës time është 0920 në mëngjez.

D.B. Ne do të kryejmë ëëë...jemi këtu për të kryer një intervistë me zotin Shukri BUJA në cilësinë e dëshmitarit...

D.B. ...në ambijentet e batalionit finlandez të KFOR-it në Kosovë.

D.B. Para se të fillojmë...para se të fillojmë unë dua ti...ti kujtoj të pranishmit këtu se mund të kemi probleme të ndërprerjes së rrymës sot, kështu që mund të kemi dhe probleme të incizimit.

D.B. Unë...para se të fillojmë do t'i kërkoja secilit që është i pranishëm këtu që të prezentojë veten e tij.

D.B. Unë quhem Ule LEHTINEN dhe unë jam hetues në zyrën e prokurorit në Tribunalin ndërkombëtar të Hagës.

D.B. Unë quhem Alek Uajting. Unë jam ju...jurist gjyqi në zyrën e prokurorit në Tribunalin e Hagës.

D.B. Unë quhem Fat ëëë...unë quhem Endru Kajli. Unë jam prokurori që merret me çështjen kundër Fatmir Limës dhe tjerëve në Tribunalin Ndërkombëtar të Hagës.

D.B. Unë jam përkthyesi, Durimi, me Tribunalin, sigurisht.

S.B. Unë jam Shukri BUJA,

S.B. ...i lindun më vitin 1966 në Bujan...

S.B. ...në Bujan të komunës t'Lipjanit.

D.B.Për shkak të...për shkak të mungesës... për shkak të mungesës të hapsirës ëëë...jo ëëë...jo çdokush paraqitet në video, kështu që po i kërkoj prokurorit që të ngrihet dhe të tregojë fytyrën e tij në video ëëë...kasetë.

DRAFT TRANSLATION

D.B. Zoti BUJA, a keni probleme me gjuhën e përkthyesit? A e kuptoni shqipen që flet ai?

S.B. Sigurisht që po.

D.B. Çdo gjë që do të thuhet në këtë dhomë do të përkthehet nga shqipja në anglisht dhe nga...nga anglishtja në shqip.

D.B. Kështu që ne do t'ua bëjmë pyetjet në anglisht të cilat do t'ju përkthehen ju në shqip dhe anasjelltas, ju do të përgjigjeni në shqip dhe përgjigjet tuaja do të përkthehen në anglisht prej përkthyesit.

D.B. Veç...veç pyetjeve-përgjigjeve, nuk ëëë...nuk lejoheni që të diskutoni me përkthyesin,

D.B. ...vetëm në rastet kur ka paqartësira në lidhje me gjuhën ose me...me ndonjë paqartësi në lidhje me pyetjet.

D.B. A i kuptoni të gjitha këto?

S.B. Po.

D.B. Dëshiroj të filloj pak me informacion personal.

D.B. Ju lutem emrin e plotë.

S.B. Quhem Shukri.

S.B. Emri i babës Gani,

S.B. ...mbiemri BUJA.

D.B. Ëëë...datëlindja juaj?

S.B. 27...

S.B. ...08-1966.

D.B. Vendlindja juaj?

S.B. Bujan, Lipjan.

D.B. A jeni i martuar?

DRAFT TRANSLATION

S.B. Po.

D.B. A keni fëmijë?

S.B. Po.

S.B. Tre fëmijë.

D.B. Djem, vajza?

S.B. Dy djem, një vajzë.

D.B. Dhe cila është adresa juaj e tashme? Ku banoni?

S.B. Prishtinë, Dardani, lagja "Dardania",

S.B. ...9/4.

D.B. /e pakuptueshme/.

S.B. 9/4.

D.B. Çfarë është kjo? Është...

S.B.Do të thotë, llamella nëntë, vizë, katër. Nuk e di se si quhet.

D.B. Apartament?

S.B. Po, po, apartament.

S.B. Kështu, vizë.

D.B. Nëntë dhe vizë, katër pastaj.

S.B. Po, po.

S.B. Numër 22, numri i banesës

S. B. 22.

D.B. Thatë që jeni lindur në Bujan.

S.B. Po.

D.B. Fëmijërinë e keni kaluar në Bujan? Atje keni jetuar?

S.B. /Po/.

D.B. Çfarë pune bënte baba?

DRAFT TRANSLATION

S.B. Baba, bujk.

D.B. Çfarë shkollash keni kryer? Çfarë arsimi do të thotë? Prej fillimit.

S.B. Kam kryer shkollën e mesme në Lipjan, edhe shkollën fillore, kuptohet.

D.B. Në fshat?

S.B. Në fshat, po. /?katërvjeçaren/.

D.B. Shkollën...shkollën e mesme?

S.B. Shkollën e...katërvjeçaren n'fshat, katërvjet në Krajishtë,, n'fshat tjetër,

D.B. Tetë vjet është arsimi ëëë...fillor?

S.B. Fillor.

S.B. Shkollimin e mesëm në Lipjan.

S.B. Kam vazhduar studimet në Prishtinë.

D.B. Ëhë, në universitet.

S.B. N'univerzitet,

S.B. ...shkollën e lartë pedagogjike.

D.B. Në...për...për studime pedagogjike, për mësues?

S.B. Po...jo, drejtimi i matematikës, se ashtu kanë qenë të ndame.

D.B. Domethënë për matematikë. Do të thotë ëëë...n'universitet keni kryer ëëë...

S.B. Kam vazhduar studimet, s'i kam kry....shkalla e matematikës, pastaj jam burgos.

D.B. Ju i keni...më fal se kjo ishte e paqartë, ju i keni vazhduar studimet n'universitet dhe i keni ndërprerë?

S.B. Unë i kam vazhduar studimet në univerzitet dhe më janë ndërprërë nga Sërbia.

D.B. Kur ju kanë ëëë...kur ju kanë larguar prej shkolle, prej universiteti do të thotë? E mbani mënd kur, si kohë?

S.B. Po. Jam largu në vitin 1989 kur jam burgos.

D.B. '89?

DRAFT TRANSLATION

D.B. A i...më vonë, a i keni ëëëë...përfund... i keni kryer studimet n'universitet?

S.B. Pas ëëë...pas lirimit nga burgu,...

S.B. ...kam ikur n'Zvicër.

S.B. E kam vazhduar studimin me korespodencë në gazetari.

S.B. Edhe kam punu një kohë edhe si gazetar.

D.B. Çfarë pune keni tani, çfarë pozicioni ëëë...keni në këtë moment? Çfarë pune bëni?

S.B. Ëëë...s'di si ta quaj! Biznis privat.

S.B. Jam edhe anëtar i Këshillit Drejtues të partisë Demokratike të Kosovës në nivel të Kosovës.

D.B. Çfarë...çfarë biznesi keni? Biznes privat?

S.B. Po kemi...kam pas nji depo të materialit ndërtimor. Tash kam fillu...kam ndërru biznesin. Kam fillu me derivate t'naftës.

D.B. Në...në produkte...nënprodukte të naftes? Në...në...

S.B. Po, derivate.

D.B. Kështu, ëëë...importoni dhe ëëë...jeni ....

S.B. Jo, unë mirrem vetëm me...me shitje të vogël. E kam një pikë karburante.

D.B. A mund të na e përshkruani shkurtimisht për çfarë ishte ëëë...burgim...burgosja juaj në '89 që e përmëndët?

S.B. Po. Unë jam marr me organizimin, kam qenë në organizim, kuptohet kundër pushtuesit sërb.

S.B. Jam marr me organizimin e demostratave.

S.B. Edhe për organizim të demostratave, shpërndarja e trakteve, shkruarja e parullave...

S.B. Ëëë...jam burgos nga policia sërbe në një aksion.

DRAFT TRANSLATION

S.B. Jam akuzuar me nenin 139,

D.B. 139?

S.B. ...lidhur me nenin 114. Kështu ata i kanë thënë, lidhur me nenin 114.

D.B. Veç nenit 139 edhe neni 114?

S.B. Neni 139 lidhur me nenin 114.

S.B. Shkalla e dytë e gjykimit ka hequr nenin 139 dhe ka mbetur neni 114, do të thotë.

D.B. Cilin nen e hoqi?

S.B. Hoqi 139, mbeti vetëm 114.

S.B. Këto ishin /e pakuptueshme/.

D.B. Ëëë...sa ishte dënimi i gjatë, kohëzgjatja e dënimit?

S.B. Kohëzgjatja e dënimit ishte 13 vite.

S.B. Ëëë...shkalla e dytë, pas heqjes së nenit 139, zbriti në 9 vite,

S.B. Ndryshimet që ndodhën në ish Jugosllavi ëëë...do të thotë, fitova amnestionin për shkak se isha i burgosun politik.

D.B. Në...në cilin vit?

S.B. Fitova amnestionin, do të thotë, kam qenë ëëë...deri n'vitin ëëë...'94 jam mbajt n'burg.

D,B. Në...në cilin burg ju kanë çuar për me e vuajt dënimin?

S.B. Ëëë...s'pari kam qenë në burgun hetues të Prishtinës,

S.B. ...pastaj jam, pas dënimit do të thotë, jam dërguar në burgun e Dubravës.

S.B. Jam bartur nga Dubrava në Gjurakofc.

S.B. Nga Gjurakofci prap në Dubravë,

S.B. ...dhe në burgun e Nishit, pjesën më të madhe t'burgut.

D.B. Për shkak të profesionit tuaj të mëparshëm si gazetar, a keni shkruajtur në...në shtyp për...për përvojën tuaj do të thotë si aktivist, si veprimtar i UÇK-së?

DRAFT TRANSLATION

S.B. /e pakuptueshme/

D.B. Thjeshtë, prej përvojës tuaj që keni marr pjesë në...në lëvizje, në...në UÇK, a keni shkruar, a keni kontribuar për artikuj në shtyp?

S.B. Ëëë...jo. Mund të them jo. ëëë...

S.B. ...do të thotë, unë kam hyrë në Kosovë për të marr përgjegjësinë e informimit apo të gazetarisë, mirëpo ka ndryshuar funksioni im pasi...pasi kam hyrë në Kosovë.

S.B. Ndërsa, në pjesën e gazetarisë të paraluftës siç llogaritet, unë ëëë...kryesisht kam ëëë...redaktu shkrimet për UÇK-në, shkrime që kanë qenë pro-UÇK-së.

D.B. Po pas luftës, a keni shkruar historinë ose përvojën tuaj të... ëëë...të luftës?

S.B. Ëëëë...unë jo, drejtpërdrejt. Është pak ëëë...nuk është logjike t'a shkruj për vetveten.

S.B. Edhe mund të keqkuptohet.

D.B. Kur keni qënë...gjatë fëmijërisë suaj...ëëë...familja juaj ka qënë e angazhuar në politikë? Ka qënë aktive në politikë?

S.B. Po, thuajse e gjithë familja.

D.B. Ëëë...cilën parti përkrahnit në atë kohë?

S.B. Po...

D.B. Familja do të thotë cilën parti përkrahte, se ju ishit fëmi sigurisht.

S.B. Ëëë...nuk po e kam të qartë në cilën periudhë.

D.B. Ëëë...gjatë fëmijërisë suaj.

S.B. Ëëë...gjatë fëmijërisë sime do të thotë, unë s'kam mund t'a dijë.

D.B. Por ëëë...çfarë ju vjen fillimisht në mëndje në lidhje me këtë pyetje?

S.B. Po kryesisht kemi ëëë...jemi mundu t'a përcjellim Shqipërinë, televizionin shqiptar, radion shqiptare, do të thotë...

S.B. Më vonë dikur, në moshën do të thotë kur fillon puberteti, ëëë....

DRAFT TRANSLATION

S.B. ...kam fillu do të thotë edhe unë të...t'shoh vëllaun e madh, faktikisht Ramën, i cili ka /?fillu/ organizimin politik ëëë...kundër Sërbisë.

S.B. Do të thotë më vonë, sigurisht se...ëëë....tu u nis nga shembulli i vëllaut të madh,

S.B. ...e kam simpatizu këtë levizje.

S.B. U pata angazhu n'moshën 16 vjeçare në organizimin e demostratave.

D.B. N'atë kohë ka qenë ma shumë si veprim simpatizues...

S.B. ...n'organizimin e demostratave në Lipjan.

S.B. N'qoftë se pytem për periudhën e mëvonshme, do të thotë pas vitit 90,...

S.B. ...unë veç kam qenë n'burg n'atë kohë.

S.B. Familja ime e ka përkrah ëëë...partinë atëherë, siç e kemi konsideru si lëvizje, LDK-në.

S.B. Madje vëllau ka qenë edhe anëtar i kryesisë në nivel të Kosovës...

S.B. ...për t'u ndarë nga LDK-ja n'kohën e mospërkrahjes të LDK-së, do të thotë në një periudhë të caktume t'luftës.

S.B. Por unë kam qenë anëtar i LDK-së, do të thotë ëëë...një periudhë të caktume kohore.

S.B. Do të thotë, pas lirimit nga burgu,

S.B. ...në vitin 1994,

S.B. ...unë një periudhë kohore kam udhëheq forumin rinor të LDK-së në Lipjan.

S.B. Por ka qenë periudhë shumë e shkurtë.

S.B. /?jam desht t'iki jasht...jasht vendit/.

D.B. Veç burgimit që na e treguat, a keni pasur raste tjera kur jeni...ëëë...jeni dënuar prej autoriteteve sërbe? Do të thotë, veç përvojës tuaj të burgut prej '89 –'94, para luftës bëhet fjalë, a ka pasur raste tjera kur jeni ndaluar ose jeni...?

DRAFT TRANSLATION

S.B. Ndalu, po, ëëë...në kuptimin e...ka pas një strategji të veçantë të veprimit ëëë...Sërbia.

S.B. ...sidomos pas lirimit nga burgu ëëë...ka qenë ai presioni i vazhdushëm, do të thotë, më kanë ftu në biseda informative,

S.B. ...madje më kanë ndalë çdoherë që m'kanë pa në rrugë,

S.B. ...dhe kjo ka qenë e paduruеshme.

S.B. Mirëpo, dënime tjera nuk kam pas.

S.B. Kjo ka qenë ajo...ajo pjesa më e madhe /e pakuptueshme/.

D.B. Kur ju...kur ju kanë marr për këto biseda informative, ju mbanin për ditë me rradhë apo vetëm kryenin bisedën edhe pastaj ju...ju lëshonin?

S.B. Po, m'kanë /e pakuptueshme/ mbrenda tan ditën në pytje, pastaj më lëshonin me fjetë. Mu m'ka ndodh dy ditë, do të thotë rresht, t'jem aty, edhe pse më kanë ftu, do të thotë, që çdo ditë t'lajmërohem n'polici.

S.B. ...edhe qëllimi ...qëllimi i tyre ka qenë që njëkohësisht të t'paraqesin para popullatës si bashkëpunëtor i tyre.

S.B. Do të thotë, unë s'kam pranu që të lajmërohem çdo ditë,

S.B. ...normal, ju kam thënë "n'qoftë se ju duhem ejani" edhe m'arrestun.

S.B. Domethënë, kjo ka qenë ajo forma...ka pas shumë forma të presionit, por kjo ka qënë njëra nga ato format /e pakuptueshme/.

D.B. Si u kanë trajtuar gjatë këtyre bisedave informative? Ju kanë...a ju kanë rrah?

S.B. Ëëë...jo, aty nuk kanë...ëëë...m'rrah do të thotë, faktikisht...

S.B. Flitet do të thotë pas...pas burgut, pas lirimit nga burgu do të thotë, nuk m'kanë rrah fizikisht,

S.B. ...ndërsa para burgosjes, do të thotë n'kohën kur...para dënimit, faktikisht kur më kanë arrestu, kur m'kanë mbajt nën hetime, normal është përdorë dhuna.

DRAFT TRANSLATION

S.B. Për ato dy ditë do të thotë pas burgu ëëë...m'kanë...m'kanë marr por nuk e kanë përdor dhunën.

D.B. Kjo ishte arsyeja që ju ka detyruar që të largoheshit, që t'a lëshonit vëndin dhe t'shkonit jasht?

S.B. Ëëë...po. Këto ishin disa nga arsyet.

S.B. Po, pastaj janë grumbullu edhe problemet ekonomike, por kryesisht do të thotë ka qenë kjo.

D.B. A e mbani mend kur jeni larguar prej Kosovës?

D.B. Me afërsi, sigurisht.

S.B. Në vitin 1995, dikund është tetë-nënt muaj pasi jam ëëë...liru nga burgu.

S.B. Po n'fillim t'vitit 1995.

D.B. Para se të largoheshit nga Kosova, a kishit dëgjuar deri në atë kohë për formimin e UÇK-së?

S.B. Ëëë...formimin e UÇK-së...nuk kam ndëgjuar, se ka qënë e pamundur, por kur jam liru nga burgu ëëë...normalisht kam marr kontakt me Nait HASANIN.

D.B. Cilin keni taku?

S.B. Nait Hasanin.

D.B. Nait Hasani?!

S.B. Nait.

S.B. ...i cili ...me të cilin u takova...ëëë...në Mal të Zi gjatë pushimeve.

S.B. Edhe si shokë të burgut, si njerëz që kemi qenë bashkë në burg në Dubravë, kemi biseduar për rrjedhat politike...

S.B. ....dhe ëëë...në mënyrë të tërthortë ëëë...është potencuar edhe një organizim ushtarak.

DRAFT TRANSLATION

S.B. Sepse normalisht, Nait HASANI i ka pas rezervat e tij për të bisedu hapur kur kemi qenë...

S.B. Mirëpo, nuk kam ëëë...nuk kam menduar të organizohem në atë kohë drejtpërdrejt në...ëëë...në ndonjë organizim ushtarak apo politik.

S.B. ...n'kuptimin ilegal të organizimit.

S.B. Edhe ëëë...edhe Nait Hasani është pajtu që unë të mos angazhohem.

S.B. Madje edhe pas konsultimeve me...ëëë...njerëz tjerë të organizimit të LPK-së apo LPRK-së atëherë,

D.B. Lidhja Popullore e Kosovës?

S.B. Lëvizja Popullore e Kosovës.

D.B. Lëvizja Popullore e Kosovës.

S.B. Atëherë u quajtur LPRK – Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës.

S.B. ...si me Adnan Asllanin,

D.B. A...ëëë..as....Asllan?

S.B. Adnan Asllani.

S.B. Më...më është thënë që nuk ëëë..."nuk janë kushtet që ti të veprosh në Kosovë edhe duhet të largohesh patjetër".

S.B. Do të thotë, faktikisht, unë jam larguar me ëëë...udhëzimet edhe të LPK-së jasht Kosovës, edhe të njerëzve të cilët...me të cilët kanë qenë në organizim edhe më herët.

S.B. Ndërsa për UÇK-në, më qartë dhe më mirë kam ëëë...ndëgjuar edhe ëëë...madje pastaj edhe jam angazhuar, në Zvicër.

D.B. Kur keni filluar të ëëë...të viheni n'kontakt me njerëzit e LPRK-së? Kur e keni lëshuar LDK-në, do të thotë, kur nuk ishit më anëtar i LDK-së?

S.B. Ëëë...jo, duhet t'a kuptojmë, organizimi legal ka qenë LDK.

DRAFT TRANSLATION

S.B. Do të thotë, pozicionin tim në LDK e ka ditë Sërbia, e kanë ditë organet e ëëë...hetuesisë, sigurimit,

S.B. ...ndërsa pozicionin në organizimin ilegal, sepse LPRK-ja ka qenë organizim ilegal,

S.B. ëëë...kanë qenë kontaktet shumë ma të vështirsume edhe ka qenë shumë ma me rrezik...

S.B. ...edhe pa...pa mundësi të kontakteve t'veprimit tim, më kanë preferu apo më kanë udhëzu që të dal jasht.

S.B. Madje po ju them një detal.

S.B. Ëëë...jam informu në Zvicër...

S.B. ...se me vota kam qenë i zgjedhur anëtar i këshillit t'përgjithshëm të LPK-së në Kosovë ende sa kam qenë në burg.

S.B. Domethënë që se kam ditë as unë deri sa kam shku n'Zvicër.

D.B. Po deri sa...deri sa e keni lëshuar vendin dhe keni shkuar në...ëëë...Zvicër, vazhdonit të ishit anëtar, të ishit veprimtar i LDK-së?

S.B. Ëëë...s'di si t'a definoj tash. Është...

S.B. Unë deri n'momentin kur e kam lëshu Kosovën do të thotë, kam qenë kryetar i forumit rinor n'Lipjan.

D.B. Kështu që ju shkuat në Zvicër pasi e keni lëshuar Kosovën?

D.B. A zgjati shumë ëëë...kur keni shkuar fillimisht në Zvicër që ratë në kontakte dhe filluat të merreshit me...ëëë...me punën e UÇK-së, do të thotë, me organizimin e UÇK-së?

S.B. ëëë...jo me organizimin e UÇK-së...

D.B. Jo, me...me veprimtarinë tuaj, le t'a themi më saktë. Më fal.

DRAFT TRANSLATION

S.B. Ëëë...po ka zgjatur një kohë do të thotë sepse unë është dashur të paraqitem në organet zvicrane për të kërku azilin,

S.B. ....pastaj është ...normal është dashur të qëndroj në kamp të refugjatëve,

S.B. ...dhe ka qenë e pamundur që me mjetet që kisha, financiare, që të lëvizë...

S.B. ...por, kam fillu të kuptoj, do të thotë, kanë ardh shokët, miqtë e mi të cilët i kisha në organizim më herët, do të thotë, kam fillu të kuptoj se çka po ëëë.../?po bëhet/ n'Zvicër dhe n'Kosovë.

S.B. Mendimi im në atë kohë ka qenë që të mos ëëë...orga...organizohem në ëëë...organizime politike

D.B. Të mos organizoheni...

S.B. Të mos organizohem.

S.B. Ëëë...mirëpo, njerëzit që njihja, njerëzit që kisha vepru me ta, ëëë...m'bënë një presion bukur të madh,

S.B. ...sepse mendonin që unë mund t'kontriboj në organizimin...

S.B. ...qoftë këtu, në jetën politike, do të thotë, t'organizimit në Zvicër, qoftë edhe për të ndihmu njerëzit që po ëëë...organizonin këtu në Kosovë.

S.B. Duhet t'a kuptoni një se në Zvicër, ne kemi vepruar në aspektin politik, shembull quhet... por, kryesisht organizimet tona kanë qenë të ëëë...regjistruara si veprimtari kulturoro-politike.

S.B. Një kohë jam marr me organizimin në shoqatën "Mëmëdheu",

D.B. Shoqata "Mëmëdhe"?

S.B. Po.

S.B. Dje morra një mirnjohje për atë aktivitet.

S.B. Ajo ka qenë kryesisht organizim, në atë shoqatë, kuturor, sportiv, do të thotë, i rinisë.

DRAFT TRANSLATION

S.B. Në qoftë se ju intereson angazhimi im ëëë...i drejtpërdrejtë,

S.B....ka qenë dikund mbas shtatë-tetë muajve që kam...ëëë....që kam shku në Zvicër.

D.B. Shoqata "Mëmëdheu" ishte e angazhuar në mbledhjen e fondeve ose të të hollave, ose të mjeteve financiare, për të ndihmuar luftën e UÇK-së?

S.B. Jo, fillimisht jo. /e pakuptueshme/ si n'çdo vend pastaj edhe në Zvicër...ëëë....

S.B. ...kanë marrë ëëë....përmasa të luftës drejtpërdrejtë në Kosovë,, atëherë ka kthy organizimin e vet n'drejtim t'fondeve.

S.B. Mirëpo unë n'atë kohë nuk isha.

D.B. Ajo që po përpiqem të kuptoj ose të përcaktoj është se kur...kur keni filluar drejtpërdrejtë të kontriboni ose të merreni me...me...me...me veprimtarinë e UÇK-së në...në...në Zvicër.

S.B. Ëëë...po kur jam fut në organizatën politike, apo me LPK, ajo mund të mirret si përkrahje që i është dhënë UÇK-së n'atë kohë...

S.B. Ka qenë do të thotë...LPK ka qenë mbështetja apo përkrahja ëëë...politike ...

S.B. ...edhe materiale, ashtu është definu atëherë.

D.B. Është përsëri ajo që po flisnim çfarë LPRK-ja.

S.B. Po, thash, ndryshimi i emrit ka ndodhë.

S.B. ...tërheqja e R-së.

D.B. Sa e rëndësishme, sa e madhe ishte LPK-ja në Zvicër?

S.B. /e pakuptueshme/ me e definu. Ëëë...po ka pas këshilla të organizume në çdo rreth, pra n'çdo qytet...

S.B. /e pakuptueshme/ popullore siç jan quajt.

S.B. Në kohën kur kam shku unë atje ëëë...ka mund të ketë dikund 500 deri në...mbi 500 anëtarë....

S.B. ...si anëtarë, ndoshta simpatizantë ka pas edhe më shumë.

DRAFT TRANSLATION

S.B. Mirëpo më vonë është bë një zgjërim shumë i madh...

S.B. ...mes formës së organizimit të fondit "Vendlindja Thërret",

S.B. ...përmes organizimit pastaj të shoqatave,

S.B. ...ka pas në Gjermani e n'gjithë mërgatën.

D.B. A kishit kontakte me grupet e tjera që punonin po për të njëjtin qëllim në Evropë?

S.B. Ëëë..../e pakuptueshme/, të njestës...t'njejtit organizim apo...?

D.B. Ëëë...zotëria dëshiron të dijë për mënyrën e organizimit, do të thotë, po, të të njëjtës parti thotë dhe a ishte dikush që e koordinonte këtë lidhje, kontaktim midis ... ëëë...grupeve të ndryshme në Evropë?

S.B. Po, sigurisht.

S.B. Kishim organizimin e degës, kishte në nivel të mërgatës, do të thotë, faktikisht për të gjitha shtetet evropiane.

S.B. Do të thotë, dega kishte nëndegët e saj.

S.B. Kishim n'Zvicër, Gjermani, në Austri, Suedi,

S.B. ...edhe në vende tjera që tash për tash s'më...

S.B. ...që më vonë është zgjëru, do të thotë, n'atë periudhë ka qenë me nëndegë më të pakta.

S.B. Dega ka pas këshillin e përgjithshëm,

S.B. ...ku kam qenë edhe anëtar i këtij këshilli të përgjithshëm.

S.B. Nëse nuk gaboj, diku 37...ëëë...anëtarë këshilli drejtues i ka pas.

S.B. Ka pas kryesinë, kryesinë e...

S.B....të cilët kanë qenë organe...ka qenë organ ekzekutiv, kryesia.

D.B. Ju keni qënë anëtar i këshillit të përgjithshëm, jo i kryesisë?

S.B. Jo i kryesisë.

DRAFT TRANSLATION

D.B. Jo i kryesisë.

D.B. Gjatë...gjatë takimeve, tubimeve që keni mbajtur si organizëm politik, keni folur vetëm për...ëëë...veprimtari dhe çështje politike apo keni folur dhe për UÇK-në si ushtri, si ushtri e mundëshme, potenciale për të luftuar kundër sërbëve?

S.B. Po ëëë...organizimet...ëëë...e tubimeve që i kemi organizuar si lëvizje kanë filluar dikund në...ëëë...'97, të potencohet edhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës si organizim...ëëë...gueril, edhe pse këshilli i përgjithshëm në kohë i LPK-së nuk ka pas qartësime se çka vërtetë është kjo.

D.B. A mund të na thoni se kush kanë qënë ëëë...kush kanë qënë personalitetet kryesore të LPK-së në Zvicër për...në këtë kohë të cilën ju e cekni në ëëë...gjatë përshkrimit tuaj?

DRAFT TRANSLATION

S.B. Po. Në kuptimin e funksionit...

D.B. Po, funksionit, njerëzit më të rëndësishëm të partisë.

S.B. Kryetar i LPK-së ka qenë Fazli VELIU.

S.B. Kanë qenë Bardhyl MAHMUTI,

S.B. Emrush XHEMAJLI,

S.B. Adem GRABOVCI,

D.B. /?Drago?...

S.B. Adem, Adem GRABOVCI.

D.B. DRAGOVCI?

S.B. GRABOVCI.

D.B. GRABOVCI.

S.B. Si anëtar, por jo funksionar i LPK-së, ka qenë edhe Hashim THAÇI, por jo në funksion, do të thotë.

S.B. Ka qenë njeri i panjoftun atëherë.

S.B. Përafërsisht këto kanë qenë ndërsa në fondin "Vendlindja Thërret" është... ka qenë më i angazhuari ëëë...Jashar SALIU.

D.B. Çfarë pozite keni pasur në atë kohë?

S.B. Ëëë...po në atë kohë, do të thotë në kohën pas mbledhjes së katërt....të katërt të përgjithshme... nuk...nuk është e saktë, nuk e di sa është e saktë,

S.B. ...ëëë....m'duket është mbledhja e katërt e përgjithshme,

S.B. ...jam zgjedhur në atë kuvend anëtar i këshillit të përgjithshëm...

S.B. ...në mesin e 37 anëtarëve.

D.B. Po ju ishit një prej këtyre anëtarëve të këshillit të përgjithshëm?

D.B. Ju në një nga...ëëë...deklaratat tuaja të mëparshme dhënë Tribunalit, ju keni përshkruar që jeni kthyer në Kosovë diku nga '98, nga fillimi i '98.

D.B. A mund t'na i përshkruani shkurtimisht arsyet që ju shtynë për t'a marr këtë vendim, do të thotë për kthimin tuaj në Kosovë?

S.B. Po.

S.B. Ëëë...po sigurisht, unë kam qenë një nga ëëë...antarët e këshillit drejtues të këshillit përgjithshëm /e pakuptueshme/ në parti...këshillit t' përgjithshëm më të zellshëm që të kthehemi n'Kosovë dhe t'bëjmë ndonjë organizim.

S.B. Kryesisht ka qenë /?mendimi/ për organizim politik, sepse organizimi politik ishte shumë i zbehtë apo ...për mos me thënë fare nuk funksiononte.

S.B. Ose, arsyeja më...më e madhe që na ka shty është masakra që ndodhi në Prekaz.

S.B. ...edhe sidomos vrasja e komandantit legjendar, Adem Jasharit.

S.B. Po ajo aryja me e ëëë...madhe ishte sepse Shtabi i Përgjithshëm kishte zgjedhur emrin tim t'futem në Kosovë.

S.B. Ky ishte një nder që më bëhej.

D.B. Ju po flisni për Shtabin e Përgjithshëm në Kosovë?

DRAFT TRANSLATION

S.B. Atë nuk e kam ditë unë. A ka qenë n'Kosovë a n'Shqipëri, jo, s'e kam ditë.

D.B. Si ju kanë njoftuar që ju jeni caktuar ose emri juaj është përmëndur për t'u kthyer në Kosovë?

S.B. Po Hashim THAÇI ka qenë ëëë...ai që ka qenë n'Zvicër edhe m'ka njoftu ai që duhet të nisemi për Kosovë. Unë e kam njoft si person që ka pas lidhje me UÇK-në, do të thotë vetëm kam mujt me...me e dit që ka lidhje /e pakuptueshme/.

S.B. Dhe kemi bisedu, do të thotë, disa. Pastaj është njoftuar edhe Fehmi LLADROVCI, Fatmir LIMAJ...

D.B. Ishit caktuar pak njerëz për t'u kthyer n'Kosovë nëse e mbani mënd? Një numër i vogël si e përmëndët apo ishte një grup i madh që ishte caktuar?

S.B. Jo, ishim diku rreth 30.

S.B. Do të thotë, ishin disa nga Gjermania, disa ishin të Zvicrës,

S.B. ...ka pas të Suedisë,

D.B. Do të thoni që gjithë grupi ishte i përbërë...gjithë grupi prej 30 vetësh ishte i përbërë prej gjithë këtyre personave që vinin nga vënde të ndryshme, prej Zvicrës, Gjermanisë, Suedisë...

S.B. Po,po. Krejt grupi 30.

D.B. Po...po ju, sa...ëëë...sa persona ishit prej Zvicrës që po...ëëë...ishit caktuar për tu kthyer, kështu, me afërsi?

S.B. Po ne kemi udhëtuar diku rreth 15 veta nga Zvicra.

S.B. Mirëpo nuk kemi hy të gjithë.

S.B. Do të thotë, nga Zvicra në Shqipëri kemi arritur 15, mirëpo aty jemi ndarë pastaj.

S.B. Ëëë...jemi bashkuar, do të thotë me tjerët në Shqipëri edhe...

S.B. ...edhe diku rreth 30 kemi...jemi nisur për Kosovë.

DRAFT TRANSLATION

D.B. A kishte ndonjë mënyrë organizimi i Shqipërisë, mënyra se si u organizua grupi do të thotë, për tu nisur drejtë Kosovës?

S.B. Ëëë...po një formë e organizimit ishte në Shqipëri, prej ëëë...para se të mbërrinim ne, kishte një organizim që unë po e shihnja atje, kur arrita po e shihja organizimin, faktikisht që llogaritej si organizim apo logjistikë e UÇK-së.

S.B. Atje na kanë pritur njerëzit,

S.B. ...por rreziku nga vetë shteti shqiptar ka qenë bukur i madh atëherë.

S.B. Do të thotë, kemi qenë të ndarë nëpër shtëpia në Tiranë...

S.B. ...dhe ka qenë bukur me probleme deri sa kam...kemi mbri n'kufi.

S.B. Aty jemi bashkuar, të tridhjetit jemi bashkuar.

D.B. Ju...siç e përmendët dhe ju, ëëë...Ha...Hashim THAÇI ka ardhë dhe ka biseduar me ju dhe pastaj ju ka thënë që "do të nisemi për Kosovë". Hashim THAÇI ishte pjesë e Shtabit të Përgjithshëm apo vetë Hashim THAÇI ishte njoftuar ashtu siç ju njoftoj dhe ju?

S.B. Ëëë...kushtet e organizimit në atë kohë, sidomos në Zvicër kur është fjala, kanë qenë që...ka qenë edhe jasht logjikës me pyet "a je anëtar i shtabit të përgjithshëm?"

S.B. Ëëë...faktikisht, Hashim Thaçin e kam njoft si njeri që ka pas lidhje me UÇK-në.

S.B. Edhe...

S.B. ...edhe pos Hashim Thaçit, do të thotë, njerëzit që kanë qenë të caktum për lidhje me Kosovën si i quanim atëherë, edhe Emrush XHEMAJLI edhe disa tjerë, edhe Xhavit HALITI, edhe ata na thanë se "kjo është n'rregull, mund të niseni".

S.B. Sepse faktikisht Hashim Thaçin nuk e kemi llogarit si një njeri..ëëë...të ndonjë hier...hierarkie të organizume.

D.B. Po prej bisedave që i keni kryer me të gjithë këta njerëz që i përmendët, ju e realizuat, e kuptuat që urdhëri për tu...për me u këthy vinte prej UÇK-së?



DRAFT TRANSLATION

S.B. Po.

D.B. Ose e dini ose nuk e dini, don të thotë.

S.B. Këtë nuk e di. Faktikisht Fehmi LLADROVCI...Fehmi LLADROVCI ka tentu edhe më herët të futet në Kosovë me një grup tjetër.

S.B. Po ju ka ndodh do të thotë vrasja e një pjesëtari të UÇK-së që është Luan HARADINAJ dhe janë kthyer prap. Kanë has në rezistencë të forcave sërbe në kufi...

S.B. A këtë e kam ditur, do të thotë për Fehmiun që...

S.B. ...ai ka tentu edhe përpara...

.S.B. ...ndërsa për Fatmirin nuk e di.

S.B. Nuk e di a e ka lajmru Hashim Thaçi apo dikush tjetër.

D.B. Po sigurisht ju dini vetëm faktin që edhe ai u njoftua poashtu si ju për tu...për tu kthyer në Kosovë.

S.B. Sigurisht.

D.B. Para se të hynit në Kosovë, në kohën që ju keni qëndruar në Tiranë, a ju kanë ëëë...ju kanë transmetuar, ju kanë përcjellur detyra ose urdhëra që ju mendoheshit se do ti kryenit në Kosovë?

S.B. Ëëëë...po, pak Hashim THAÇI si njeri që e njifja në lidhje me UÇK-në edhe Fehmi LLADROVCI kur erdhëm në kufi, aty kur jemi bë të tridhjetët, edhe është biseduar se si të futemi n'Kosovë, si të marrim kontakt dhe të...ëëë...çfarë mund të punojmë atje. Faktikisht, Hashim THAÇI që nga Zvicra m'kishte thënë që "duhet të hysh në Kosovë sepse Shtabi i Përgjithshëm, gjithmonë jemi thirrë në Shtab të Përgjithshëm, e Shtabi i Përgjithshëm domethënë që duhet ëëë...të ketë njeri që do të informojë, do të thotë, në formën e gazetarisë.

D.B. Që merret me shtypin.

S.B. Me shtypin, po.

DRAFT TRANSLATION

D.B. Po kush ...kush i shpërndante, kush i caktonte detyrat do të thotë?

S.B. Po nuk ka pas ndonjë përcaktim çka është detyra do të thotë, unë kam biseduar në këtë drejtim por...ëëë...faktikisht aty janë ndarë disa detyra. Është ndarë njësiti pararojë që me na përcjell grupin, thjesht aty kanë qenë detyrat e përcjelljes së grupit deri në Drenicë.

S.B. Faktikisht përcjellja e grupit ka qenë nga njerëz që veç i njihja. Ishte ëëë...Hashimi, Hashim THAÇI, por ishin edhe disa eprorë që /e pakuptueshme/ profesional në...

D.B. Për...për me ju futë në Shqipëri a në Kosovë?

S.B. Po.

D.B. Cilët...cilët njerëz ju kanë përcjell aty?

S.B. Po na kanë përcjellë, do të thotë, faktikisht me grupin tonë që kemi hyrë, kanë qenë Hashimi, po njerëz profesional që ne domethënë, ne atë e kemi njoft si "ABEJA". /?Thojshin aty Abeja, na i thojshim aty Abeja/ edhe ...kështu e kemi njoftë, s'e di pseudonimin plotësisht.

D.B. Cili ishte pseudonimi?

S.B. "ABEJA'

D.B. "ABEJA" A?

S.B. Po.

D.B. Këta persona ishin midis grupit që ju i përmëndët?

S.B. Po, para se me /e pakuptueshme/.

D.B. Para se me ...

D.B. Dhe përsëri e keni fjalën për grupin prej 30 personash që e përmëndët më parë?

D.B. A e mbani mënd kështu datën kur...kur ëëë...kur keni hyrë n'Kosovë?

S.B. Është vështirë por e di që ka qenë muaji mars.

DRAFT TRANSLATION

S.B. E di që ka qenë 7 marsi ditë ëëë...dita do të thotë që kemi arrit n'Shqipëri.

S.B. Do të thotë, ajo datë është marr si datë e nisjes për Kosovë.

D.B. Diku nga ....jo shtatë marsi?

S.B. Shtatë marsi.

D.B. Shtatë marsi është datë e nisjes në Kosovë?

S.B. Mirret si datë e nisjes, do të thotë, faktikisht data kur kemi zbrit në Shqipëri.

D.B. Shtatë marsi faktikisht datë...është datë e mbërritjes në Shqipëri?

S.B. N'Shqipëri po.

S.B. Por ajo mirret si datë e nisjes.

D.B. Ëëë...keni përmëndur në deklaratën tuaj të mëparshme dhënë Tribunalit se ëëë...Fatmir LIMAJ ishte udhëheqës i njësitit që...që i printe grupit kur...kur keni hyrë në Kosovë, a është...

D.B. Në atë kohë a i janë caktuar atij detyra të caktuara ëëë...detyra të veçanta ose specifike?

S.B. Jo, jo. Deri sa kemi mbërri në Drenicë nuk ka pas detyra të veçanta për ne, do të thotë, këta të grupit.

S.B.Ëëë...pas mbërritjes në Drenicë,

S.B. ...atëherë është ngarku Fatmir LIMAJ...

S.B. ...t'a udhëheqë njësitin.

S.B. Do të thotë, faktikisht Fatmir LIMAJ ka udhëheq njësitin...ëëë...deri në mbërritjen në Kleçkë.

S.B. ...dhe gjithmonë nga kjo e kam llogarit si komandant timin të parë.

D.B. Kur keni mbërri në Drenicë, ju grupi prej 30 personash ishit përsëri bashkë deri në atë moment, deri sa keni mbërri në Drenicë?

S.B. Deri sa kemi mbërri në Drenicë, po.

DRAFT TRANSLATION

D.B. Keni...keni qënë së bashku 30 persona?

S.B. Po.

S.B. Ndoshta në Drenicë, faktikisht në ato fshatrat ku shihnim ushtarë të UÇK së ...ëëë...jemi shpërndarë nëpër shtëpia.

S.B. Ëëë...këtu kemi qëndru nuk e di sa ditë.

S.B. Na është dhënë urdhni do të thotë që të nisemi për të bërë organizimin në pjesën siç quhej atëherë, do të thotë, Suharekë, Malishevë, Lipjan, Shtime, Prizren, Kaçanik, që është një teritor shumë i gjërë,

S.B. Malishevë, Lipjan, Ferizaj, Shtime, Kaçanik, Elezhan, e tjerë, do të thotë ka qënë teritori komplet jasht Drenicës.

DRAFT TRANSLATION

D.B. Gjatë kohës që keni qëndruar në Drenicë a...a jeni informuar për organizimin dhe për...për ndarjen administrative...për ndarjen organizative të UÇK-së?

S.B. Ëëë...jo, nuk ëëë...nuk kemi pas mundësi të informohemi. Ne thjeshtë...ëëë...

S.B. Në atë kohë është...ëëë...ka vepruar UÇK-ja në një rreth shumë të ngushtë...

S.B. ...por edhe në natyrën time ka qenë gjithmonë që të mos pyes.

S.B. Unë kam qenë vet në burg dhe e kam ditur se në rastë se njeh shumë njerëz...

D.B. Kush...kush e ka dhënë urdhërin ...kush e ka lëshuar urdhërin që ju duhet të shkonit në këto zonat e tjera?

S.B. Po ne nuk e dinim se kush po e lëshon urdhërin, por faktikisht përcjelljen /e pakuptueshme/, përcjelljen të urdhërit e ka bërë Hashim THAÇI.

D.B. Ëëë...a jua ka...ëëë...përmëndur Hashim THAÇI faktin që Fatmir LIMAJ do të jetë komandant i këtij njësiti që do të shkojë në...në atë zonë?

S.B. Jo, po ne faktikisht e njifnim Fatmir Limën si njeri më kompetent sepse e njihte terenin.

S.B. Fatmir Limës ju ka caktu detyra me e koordinu punën me Shtab të Përgjithshëm,

S.B. ...ndërsa unë kam pas t'a koordinoj me Fatmirin.

S.B. Do të thotë, faktikisht organizimi se si do të rrjedhë, mbase nuk ka qenë një kohë ndonjë organizim, domethënë ndonjë organizim i njësiteve, është dashur të përcjell ëëë...te Fatmiri informatat, pastaj Fatmiri n'Shtab të Përgjithshëm, edhe ata të na i kthejnë pastaj se çka të veprojmë më tutje.

D.B. Kjo detyrë që u caktua, do të thotë që Fatmiri u caktua lider, udhëheqës i njësitit dhe ju u caktuat për të shkuar në një zonë ëëë...u caktuat me detyrën që do të qëndronit atje, do të...do të vendosnit bazë, do të fillonit të organizohenit... ëëë...çfarëdo lloji organizimi që do të ishte i mundëshëm?

S.B. Ëëë....Fatmir LIMAJ është përcaktuar që të shkojë të vendoset në Kleçkë, në fshatin Kleçkë, ndërsa unë e njoftova edhe një here, do të thotë Hashimin, që do të vendosem në fshatin Mollapolc të Shtimes dhe...

DRAFT TRANSLATION

D.B. Më fal, ju njoftoi Hashimi që do të vendoseshit në Mollapolc?

S.B. Jo, jo. Unë atë e njoftova...

D.B. Ke kërkuar...

S.B. ...dhe faktikisht...se në atë kohë bënim organizimin aty...

S.B. Do të thotë, faktikisht në atë kohë...ëëë...nuk kanë mund me na urdhnu "shkoni këtu, shkoni atje", se s'ka dit se ku mund të shkojmë, por ne jemi përcaktu, në cilën shtëpi të shkoj dhe ku e kam sigurinë apo ku mund të filloj organizimin.

D.B. Do të thotë, ju kishit njëfarë përparsie në vendimin që ju e gjykonit vet dhe pastaj e ...e vendosnit që ku...

S.B. Kishim pavarësi mu vendos ku, domethënë n'cilën familje, sepse nuk mund të njiheshin gjithë familjet.

D.B. Sepse...ëëë...ishte pak e...ëëë...keqkuptim. Grupi i prirë prej Fatmir Limës u caktua të shkonte në Kleçkë?

S.B. Po.

D.B. Po këtij grupi, ju...ju përcaktua një zonë ëëë...veprimi, që do të thotë, u caktuan për të shkuar në Kleçkë si grup, po a u caktua ndonjë zonë veprimi që kjo do të jetë përgjithësisht zona që ju do të veproni, kjo ishte...sepse nuk e kuptova në fillim kur ma bëri pyetjen?

S.B. Është pak problematike. Ëëë...faktikisht ne kemi pas secili të përcaktume se ku do të shkojmë, në cilin rajon do të thotë, në cilën pjesë. Ëëë...Agim Bajrami...

S.B. ...do të thotë, Agim BAJRAMI ka pas pjesën në fund atje...ëëë...Kaçanikun.

S.B. Ëëë...unë kam pas të vendosem do të thotë në pjesën e Shtimes ku e kam njoft më mirë terrenin,

S.B. ...ndërsa tre nga ata të njësitit...ëëë...kishin me u vendos në Kleçkë.

S.B. Do të thotë, ishte fjala për Fatmirin,

S.B. ...që unë n'atë kohë s'e di me emër,

S.B. ...por njëherë si "ÇELIKU";

S.B. Ishte "KUMANOVA"...

S.B. ...edhe...ëëë..."TOPI"

D.B. Këto përcaktime që ju i përmëndët, tani do të thotë që çdo person përcaktohej në një zonë ëëë...të caktuar, këto përcaktime u dhanë prej Hashim Thaçit në Drenicë.

S.B. Faktikisht orientimet si urdhër nuk janë dhënë se s'ka /e pakuptueshme/ por na janë dhënë se andej nga po shkonim ne, do të thotë nga ishte përcaktu ai rajon, po shkonim sepse nuk kishte organizim.

S.B. Do të thotë, shkonim sepse e njihnim...i njihnim njerëzit, do të thotë, unë mund t'I njihja njerëzit ëëë...më autoritativ në /e pakuptueshme/.

S.B. Do të thotë faktikisht pat fillu një organizim...organizim...

DRAFT TRANSLATION

D.B. Edhe pastaj ju na e përshkruat se ju supozohet që do të raportosh...do të raportonit mbrapsht te Fatmiri për...

D.B. A ishte...a ishte krijuar ndonjëfarë shtabi në Kleçkë në atë kohë për të cilën po flisni?

S.B. Kur jam kthy do të thotë, faktikisht ëëë...n'fillim në Kleçkë nuk ka pas, se kanë shku tre ushtar, janë ndalë në një vend tjetër, ne kemi hec përpara me Agim Bajramin, do të thotë një natë përpara jemi largu nga territori i Malishevës,

D.B. Ëëë...më fal.

D.B. Ta ëëë...më fal, ju keni qënë pjestar i ngjarjeve dhe ju e përcillni ngjarjen me mënd. Unë duke mos ditur gjë jam i detyruar që t'a përcjellë fjali për fjali.

S.B. Çashtu.

D.B. Fillimisht nuk ka pas ushtarë në Kleçkë?

S.B. Jo, jo.

D.B. Pastaj ju mund të vazhdoni më tutje me përshkrimin.

S.B. Faktikisht ne kemi arritur në Kleçkë, domethënë kemi qenë veç dy.

S.B. Kam qenë unë dhe Agim BAJRAMI,

S.B. ...të cilët e kemi marr një person në Kleçkë...

S.B. ...që e njifte "Çeliku", Fatmiri,

S.B. ...ëëë...të na e tregojë rrugën për të arritur deri në fshatin tim.

S.B. Do të thotë, ka qenë Sadik ëëë...SHALA.

S.B. Është dëshmor.

S.B. Ndërsa një natë më vonë...më vonë e kam kuptuar, do të thotë, s'kam mund t'a di n'atë kohë, do të thotë, një natë më vonë ka arritur Fatmiri, se aty jemi dalë në një fshat, Pagarushë thirret.

D.B. Po ju nuk e dinit në atë moment që kanë...

DRAFT TRANSLATION

S.B. Jo.

S.B. Do të thotë, nuk e kam ditur në cilën ditë do të vendoset,

S.B. ...por kontaktet i kishim lënë që ti marrim në Kleçkë, unë dhe Fatmiri.

S.B. Do të thotë, kontaktet përmes korierëve apo...

S.B. ...që do të përcaktoheshin më vonë.

S.B. Korierë që do të parcaktoheshin më vonë...

S.B. Se Fatmiri më njihte me emër dhe mbiemër dhe ma njihte edhe familjen...

S.B. ...edhe pse unë nuk e njihja.

S.B. /e pakuptueshme/ për shkak të angazhimit politik, burgosjes, burgosjes t'vëllaut, do të thotë faktikisht na njihnin si familje.

S.B. Do të thotë, unë duhej të prisnja që të çonte ai një korier për tu marr vesh se kur do të marrim kontaktin tjetër.

D.B. Këto ngjarje që po i përshkruani, do të thotë këtë mënyrë veprimi, kjo...ëëë...ju keni parasysh kohën mars apo prill, gjatë kohës...

S.B. Mars, mars.

D.B. Mars.

S.B. Fillimi i...

D.B. Fillimi I marsit?

S.B....i organizimit.

D.B. Fillimi i organizimit.

D.B. Koha sipas orës time është 1037.

D.B. Do të bëjmë një pushim të shkurtër.

D.B. A e...ëëë....e pini kafen me sheqer e qumësht?

S.B. Po.

D.B. Të dyja?

DRAFT TRANSLATION

D.B. Në rastë se keni nevojë të shkoni në banjo, sigurisht që do t'ua tregojmë jashtë.

S.B. Më shumë kam nevojë për me dhezë cigaren.

D.B. Sigurisht do t'a ndezni cigaren jashtë.

S.B. Falemderit.

D.B. Koha sipas orës sime është 1056...

D.B. ... ne do të vazhdojmë intervistën.

D.B. A jeni i kënaqur me mënyrën se si po kryhet intervista deri tash?

S.b. Sigurisht.

D.B. Ju lutem, në rastë se keni shqetësim me...me çdo që t'keni shqetësim apo në rastë se në moment ndiheni që nuk është...nuk...ëëë...me mënyrën se si kryhet, ju lutem na e bëni të ditur.

D.B. Po punon dhe kjo, kondicioni i ajrit.

S.B. Ajri është i nxehtë jasht edhe kjo po na ndihmon.

D.B. Siç e dini zoti BUJA, ne kemi kryer shumë hetime për...për këtë çështje dhe kryesisht përqëndrohen në periudhën pranvera e '98 deri diku andej gusht-shtator i '98.

D.B. Ne kemi marr informata, kemi marr shumë informata prej njerëzve që kanë punë ose pozita të ndryshme,

D.B. ...në mënyrë që të kemi një pamje të qartë mbi...mbi mënyrën e organizimit të UÇK-së në atë kohë.

D.B. Tani dëshiroj që të flasim pak për periudhën...për periudhën të fundit të marsit dhe përtej prillit për mënyrën...për kohën që ju shkuat në atë zonë dhe filluat do të thotë veprimtarinë.

D.B. Do të...do të...do t'ju paraqes një hartë,

D.B. ...kështu që ne mund t'i...mund t'i tregojmë disa vënde gjatë bisedës.

D.B. Dhe për arsye të incizimit,

DRAFT TRANSLATION

D.B. ...harta ka numrin U0033372.

D.B. Kështu që gjatë bisedës ju jeni i lirë në rastë se dëshironi të bëni edhe shënime me ëëë...në hartë.

D.B. A...a e njihni domethënë pamjen në hartë?

D.B. ...që është rruga Prishtinë-Pejë.

D.B. Ju...me sa...me sa di unë, ju e keni...e keni pas vendosur shtabin në Krojmir.

D.B. A është e saktë kjo?

S.B. Ëëë...

D.B. Që keni ngrit shtabin në për...në Krojmir?

S.B. Ëëë...është quajt shtab nga popullata,

S.B. ...sepse nuk ka pas definim të organizimit tonë në atë kohë.

D.B. Po Krojmiri a ishte kështu si qëndër e...e...ëëë...veprimtarisë tuaj në atë ...në atë zonë ku...ëëë...ku filluat jut ë vepronі do të thotë?

S.B. Ka qenë një periudhë, do të thotë në...ëëë...jam vendos në Krojmir në maj...

S.B. Mirëpo, vendqëndrimi im në Krojmir nuk ka qenë i definum,

S.B. ...për shkak se unë kam qenë i ngarkum do të thotë ta bëj koordinimin e punëve që nga Kaçaniku.

S.B. Do të thotë, faktikisht në Krojmir kur...ëëë...ka pas ofanziva ose kur ka pas luftime, unë...ëëë...kam qenë i detyrum, do të thotë edhe mos t'kisha dashur, të rri n'Krojmir.

D.B. Ëëë...ju ishit i detyruar të qëndronit në Krojmir...

S.B. Po, po....

D.B. ...për shkak të ofensivave?

S.B.....të ofanzivave.

D.B. Ju thatë se popullata civile e quante...e quante atë...i referohej si shtab?

DRAFT TRANSLATION

S.B. Po.

D.B. Gjithashtu...po neve dëshirojmë tu informojmë se ne kemi marr informata dhe prej...ëëë...ushtarëve apo anëtarëve të UÇK-së,

D.B. ...duke përfshirë dhe anëtarë të rëndësishëm të UÇK-së.

D.B. Po dhe ata i referohen ose e përmëndin këtë...këtë vend si shtab.

D.B. Edhe kemi mësuar për...edhe...edhe ata na kanë informuar për këtë...mënyrën e organizimit ose strukturën e organizimit.

S.B. Po...ëëë...faktikisht, do të thotë ushtarakët...ëëë...që mundohen ta paraqesin organizimin e UÇK-së të një nivelit të lartë në atë kohë, bëjnë gabime të tilla,

S.B. ...sepse....

S.B. ...për shembull, edhe vendosja në...ëëë...Petreshticë,

S.B. ose në Blinajë,

S.B. ...shtëpia ku ka ndejt komandanti i njësisë,

S.B. ...ëëë...është quajt shtab.

S.B. Faktikisht, nuk...ëëë...nuk dihej, unë mund t'a quaj shtab, edhe unë,

S.B. ....por, si t'a definoj? Shtab i kujt?

D.B. Ne do të...më vonë do t'ju bëjmë pyetje që të spjegohet kjo histori, por...ëëë...vetëm dëshironim që tu iformonim për këtë fakt.

D.B. Ëëë...një arsye tjetër që ne e bëmë këtë pyetje në lidhje me shtabin do t'ua spjegojmë....do t'ua spjegoj tani.

D.B. Gjatë kësaj kohe shumë...shumë burra, shumë meshkuj do të thotë, filluan të bashkoheshin...me u bashkuar me UÇK-në.

D.B. Dhe për shembull, ata përmëndnin faktin që ata në...gjatë prillit '98 shkuan dhe u lajmëruan në shtabin në Krojmir., për të filluar aktivitetin si...si ushtarë të UÇK-së.

DRAFT TRANSLATION

D.B. Edhe ata përmendin faktin se ata u lajmëruan, do të thotë në...në atë vend ku Shukri BUJA ishte...ëëë...domethënë, u...u regjistruan prej Shukri Bujës si ...si t'a thuash në Shqip...ëëë...në atë shtab.

D.B. A është e saktë kjo?

S.B. Po, e saktë por shtab...ëëë...vërtet është thënë që "po shkoj n'shtab". Po e...po e marr një shembull që të kuptoni më mirë.

DRAFT TRANSLATION

D.B. Edhe ata përmendin faktin se ata u lajmëruan, do të thotë në...në atë vend ku Shukri BUJA ishte...ëëë...domethënë, u...u regjistruan prej Shukri Bujës si ...si t'a thuash në Shqip...ëëë...në atë shtab.

D.B. A është e saktë kjo?

S.B. Po, e saktë por shtab...ëëë...vërtet është thënë që "po shkoj n'shtab". Po e...po e marr një shembull që të kuptoni më mirë.

S.B. Gjithë Reçaku, fshati Reçak, e ka quajt shtab shtëpinë ku kanë ndejt ushtarët

S.B. Dhe..ëëë...problemet janë që aty s'ka pas shtab,

S.B. ...sepse nuk ka pas strukturë që mund të quhet shtab

S.B. Ka pas një komandant, të njësisë,

S.B. ...dhe një zëvendës i tij.

S..B. S'ka pas...s'kemi pas të bëjmë me shtab.

S.B. Ndwrsa....nw Krojmir,

S.B. ...ëëë...duhet ta keni parasysh periudhën e daljes në publik të UÇK-së.

S.B. Në Krojmir jemi vendosur në një shtëpi,

S.B. ...ëëë...diku dhjetë ushtarë,

S.B. ...dhe pastaj kemi fillu të zgjërohemi

S.B. ...dhe ...ëëë...veç shikimi në atë shtëpi do të thotë njerëzit i ka shty që shtabi i UÇK-së...

S.B. Se në kuptimin organizativ shtab nuk ka pas.

D.B. E kuptoj se çfarë doni të thoni.

D.B. Po ju...ju...ju si person e njihni mjaft mirë strukturën ushtarake.

D.B. Ëëë....unë...unë e kuptoj edhe njëherë ta filloj atë çka doni të thoni për ...ëëë...unë e kuptoj dhe këtë tjetrën që gjërat nga ana ushtarake po fillonin po

DRAFT TRANSLATION

zhvilloheshin...ëëë...ishin në formimin e sipër. Por gjithsesi duhet të them që vendi, ai vend, vendndodhja në Krojmir funksiononte si shtab. A...a është e saktë kjo?

S.B. Shtab quhej, por nuk funksiononte si shtab edhe kjo...

S.B. Është e vertetë se kanë ardh dhe janë regjistru njerëzit,

S.B. Janë regjistru për tu angazhu si ushtarë të UÇK-së.

S.B. Ka qenë i angazhum njeriu për këtë punë, do të thotë të regjistrojë,

S.B. ....dhe ata njerëz dërgoheshin në Shqipëri për tu armatosë.

S.B. Ëëë...periudha e ndodhive të tilla ka qenë periudha e majit dhe qershorit,

S.B. ...kur edhe është hap rruga për Shpipëri, në kohën...në Malishevë kur...

S.B. N'atë kohë do të thotë puna ime ka qenë coordinator i veprimit në pjesën Kaçanik, Ferizaj, Shtime,

S.B. Do të thotë, vetë koordinimi im është bërë me Fatmir Limën i cili ka qenë i vendosur në Kleçkë.

S.B. Kur janë zgjëru ushtarët e UÇK-së në ...nga Krojmiri, do të thotë një dhjetësh në Krojmir, për shembull, kur janë zgjëru, do të thotë jemi nis në drejtim të Petreshticës që të vendosim pikat. A në atë kohë ka qenë edhe ...

D.B. Kur jeni zgjeruar, kur është rritur numri i...?

S.B. Kur është rritur numri, kur ka fillu të rritet, por fillimi i rritjes të numrit ka qenë aq i shpejt, shumë i shpejt ka qenë, ka ndodh t'lunte mbrenda ditës...

S.B. Dhe në atë kohë ka qenë edhe një ndryshim tjetër i prganizimit.

S.B. Kështu nuk ka qenë ndonjë strategji ...strategji ushtarake, por janë vendos dhe janë quajt pika.

S.B. Për shembull, pika në Llapushnik,

S.B. ...pika në Fushticë,

S.B. ...n'Petreshticë, e tjerë



DRAFT TRANSLATION

S.B. Do të thotë, në atë kohë ne...ëëë...ka qenë edhe nga Shtabi i Përgjithshëm një person që ne nuk e kemi dit a është njeriu përgjegjës, po është paraqitur do të thotë e kemi njoft prej më herët faktikisht si anëtar i Shtabit të Përgjithshëm edhe i ka përcaktu pikat në Petreshticë.

S.B. Do të thotë, faktikisht ky rajon është bërë rajoni ku ka fut nën kontroll UÇK-ja pa ndonjë luftë.

S.B. ...edhe ka fillu do të thotë të paraqiten njerëzit dhe të shkojnë t'armatosen dhe të zgjerohet shumë shpejtë /e pakuptueshme/

D.B. Dhe unë...ëëë...sipas informatave që kam, gjërat me të cilat...aktivitetet që u morrët ju atëherë ishin...ishin organizimi i ...ëëë...i çeljes së istikameve, të llogoreve,

D.B. Po pavarësisht faktit nëse kishte ose nuk kishte luftime, unë dëshiroj të theksoj...ëëë...momentin që kishte njëfarë structure në...në ...në atë zonë, në atë trajtim do të thotë.

D.B. Unë...me sa e di unë...ëëë...në prill të '98 kishte takime javore të rregullta në Kleçkë.

D.B. A...a keni marr pjesë në këto takime të rregullta javore?

S.B. Jo, sepse unë nuk kam qenë pjesë e komandës të Kleçkës.

S.B. Kanë qenë raste të veçanta kur kam marr pjesë.

S.B. Për shembull, në maj,

S.B. ...unë kam qenë pjesën më të madhe të majit, në pjesën Ferizaj-Kaçanik,

S.B. ...për shkak të koordinimit të punës me komandant Agim Bajramin se...

S.B. Me detyrë të veçantë vijën e furnizimit, me armë.

D.B. Ishte detyra juaj.

S.B. Dhe njëkohësisht, kur kam qenë do të thotë, në ato teritore, në Krojmir, unë kam ndihmuar. Atëherë nuk ke mund...s'e kemi definu as si kompani, as si bataljon,

DRAFT TRANSLATION

as...por pika. Kam ndihmuar do të thotë të shiqohen pozicionet, kanalet, bunkerat, e tjera.

S.B. Dhe kam pas thash që...ëëë...përkrahje te Fatmiri, apo te...ëëë...Shtabi i Përgjithshëm, do të thotë që unë si kam dit antarët, por e kam njoft...ëëë...Fatmirin. N'atë kohë kam mendu se është anëtar i Shtabit të Përgjithshëm.

S.B. Deri sa e kam marr...në fund të '98 kam kuptu se ai s'ka qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm.

S.B. Kam pas do të thotë mundësi që t'i them se mund të vendoset në...për shembull në Petreshticë...ëëë...të vendoset një njeri që të komandojë këtë pikë, një njeri që është dasht të vendoset. Shpesh edhe nuk ma kanë marr propozimin por e kam propozu.

S.B. Dhe siç...ëëë...kam mendu unë për Fatmirin se është anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, shumica kanë mendu edhe për mu se unë jam anëtar i Shtabit të Përgjithshëm.

D.B. Në fund të...në prill të '98, në fund të prillit të '98, sa ushtarë ka pas në Krojmir?

D.B. Me...me përafërsi.

S.B. Www...prill '98.

D.B. Bëhet fjalë fund ii prillit '98.

S.B. Nuk di nëse ka pas një njësi, a ka qenë fund prilli apo fillim maji kur janë vendosur ushtarët në...ëëë...në Krojmir. Kanë qenë dikund tetë apo ...nuk e di.

D.B. I...I ...

S.B. Po ajo ka qenë fund prilli apo fillim maji.

D.B. Dhe ju ishit komandant në Krojmir në atë kohë?

S.B. Www...jo, nuk...

D.B. Ose ju...ju...ju e ...i organizuat, ose..

DRAFT TRANSLATION

S.B. Ëëë...duhet të qartësohet kjo. Ëëë...faktikisht unë...kam qenë në Kaçanik, nuk e di, ka qenë fillim maji apo në fund të prillit, kur kam sjell armët e para nga...nga Kaçaniku...

S.B. ...edhe kur jemi vendos faktikisht në Krojmir,

S.B. ...kur kam gjetë organizimin aty, do të thotë, ushtarët që kishin ardhë nga jasht,

S.B. Kanë qenë diku tre apo katër ushtarë të ardhur nga jasht...

S.B. ...të cilët kanë qenë edhe të Krojmirit.

D.B. Www....

S.B. Të Krojmirit, të fshatit Krojmir.

D.B. Të fshatit.

S.B. Edhe faktikisht ata edhe e kanë bë shpërndarjen e armëve njerëzve të cilët e kanë mendu që janë më të mirët për me qenë ushtarë të UÇK-së.

S.B. Edhe unë normal, në kontakt me Fatmirin,

S.B. Do të thotë, kam kërku që ku të vendosemi dhe çfarë veprimesh të bëjmë, me që ishim në Krojmir.

D.B. I keni....i keni tregu Fatmirit?

S.B. Kam kërku nga Fatmiri çka të bëjmë.

D.B. Kush ishte si personi përgjegjës në Krojmir në atë kohë? Ishit ju?

S.B. Ëëë...n'atë kohë kemi qenë dy. Do të thotë faktikisht nuk e di cili është i pari.

D.B. Ishit ju dhe kush tjetër?

S.B. Unë dhe ...ëëëë..."Luani" që...Ramiz QERIQI.

D.B. Ju të dy ishit...ëëë...kështu si në ngarkesë të Krojmirit?

S.B. N'Krojmir.

D.B. Po flasim për fundin e prillit '98.

S.B. N'fund prilli ose fillim maji.

DRAFT TRANSLATION

D.B. Kështu që Fatmir LIMAJ në atë kohë ose kontaktonte me ju ose kontaktonte me "Luanin" në mënyrë të drejtpërdrejtë?

S.B. Po, me njërin, do të thotë edhe një...se unë nuk kam mund të vendos për shumë shkaqe, edhe për shkaqet kryesore kanë qenë se unë nuk i kam njoft njerëzit.

D.B. Unë...unë nuk ju pieta për këtë por ju pieta vetëm për faktin që Fatmir LIMAJ ishte në kontakt, do të thotë që kontaktonte ose me ju ose me "Luanin" në mënyrë të drejtpërdrejtë?

S.B. Kështu është.

D.B. Dhe Fatmir LIMAJ ishte gjithashtu personi që kishte lidhjet e drejtperdrejta me...me Shtabin e Përgjithshëm, kudo që të ishte Shtabi i Përgjithshëm?

S.B. Faktikisht ishte koordinator i kësaj punës.

D.B. Kështu që, në rastë se mund ta përshkruajmë strukturën, kemi një Shtab të Përgjithshëm që është mbi të gjitha, dhe në mes si pik kordinuese qëndron Fatmir Limaj dhe pastaj përcjellja bëhet ...ëëëë...pika tjetër ku Fatmir Limaj e përcjell është...jeni ju dhe "Luani". A është e saktë?

S.B. E sakt është, vetëm një që /e pakuptueshme/ ka përcjell do të thotë, unë kam qenë i ngarkum edhe me territor tjetër edhe faktikisht kam qen kordinator edhe në Kaçanik që e spjegova më herët...

D.B. Çfarë...çfarë më përshkruat mua edhe një herë?

D.B. Do të thotë është një strukturë elementare, po e marrim struktura në formën më të thjeshtëzuar të saj.

D.B. Do të thotë që në majë fare është shtabi kryesor i UÇK-së,

D.B. Një shkallë më poshtë vjen Fatmir Limaj në...

D.B. ...në Kleçkë.

DRAFT TRANSLATION

D.B. ...dhe poshtë Fatmir Limës vini ju dhe "Luani" në Krojmir, do të thotë, sit ë thuash, nga pikpamja hierarkike.

D.B. Këtë donit të thoshit do të thotë në këtë mënyrë se si e përshkruat këtë?

S.B. Natyra e "Luanit" dhe e imja kanë qenë të ndryshme.

D.B. Edhe një herë ta përsërisim pyetjen.

D.B. Unë nuk jam i interesuar për të ditur se çka...ëëë...çfarë detyrash kishit ju dhe "Luani".

D.B. Unë dua vetëm që të...ëëë...të konfirmoj prej jush nëse...në këtë periudhë që po flasim, fund ii prillit '98,

D.B. ....ishte një strukturë kështu fillestare e....e....një strukturë fillestare.

D.B. Do të thotë, Shtabi Qendror;

D.B. Fatmir LIMAJ merr udhëzime prej Shtabit Qëndror;

D.B. ...dhe ju dhe "Luani" në Krojmir merrni udhëzime prej Fatmir Limës.

D/B/ A është e saktë kjo?

S.B. Në rrëgull është. Deshtë të sqaroj diçka tjetër, po në rregull.

D.B. Falemderit.

D.B. Në...në atë kohë që...për të cilën po flasim, Fatmir LIMAJ ishte...ishte i vendosur në Kleçkë?

S.B. Në Kleçkë.

D.B. Dhe a ishte mënyra se si proçedohej që ose ju ose 'Luani" mund...mund të shkonit dhe të përcillnit ato takimet javore në...në Kleçkë?

S.B. Ëëë....takimet javore...tash unë nuk di që ka pas përcaktim të takimeve javore,

S.B. ...por unë kur kam pas punë, do të thotë kam shku tdrejtpërdrejt në Kleçkë.

S.B. Do të thotë, drejtpërdrejt me Fatmirin,

S.B. ...pa ndonjë prezencë të ndonji komande, ndonji shtab që ka mund me vendos për këtë punë.

D.B. Në fillim të majit të '98,

D.B. Ëëë...në fillim të majit të '98, siç...siç ju ju referuat këtyre qendrave si pika, po le të themi të ashtuquajturat shtabe, këto pika ose shtabe veç Krojmirit ...ëëë...

D.B. A kishte pika tjera të ngjajshme si Krojmiri që ishin nën...nën përgjegjësinë e Kleçkës në...në rrethinë, në zonë?

S.B. Po, ka pas. /e pakuptueshme/ përcaktimi se kur kanë qenë...ëëë...kur është vendos ajo pikë, sa kohë, është pak me vështirësi, por ka pas. Do të thotë...

D.B. A mund...a mund të shkruani...ëëë...

D.B. A mund të shkruani "Shtabi i Kleçkës"?

D.B. Një si punë /?organigrame/ do të të thotë, një...t'i...t'i spjegoni strukturën do të thotë. Do të thotë, është pika ose shtabi, quani si të duash, i Kleçkës dhe një kuti, që do të thotë Kleçka dhe pastaj tregoni se kë kishtë kKleçka nën përgjegjësinë e saj.

D.B. Do të thotë dhe në mënyrë hierarkike ...ëëë...si i përcillte urdhërat Kleçka, që do të thotë, këto pikat e ngjajshme që i përshkruat ju, Krojmir e të tjerat.

D.B. A mund t'i vizatoni, t'i emërtoni pikat që merrnin urdhërat prej Kleçkës, do të thotë, një nivel më poshtë se Kleçka në...

S.B. /e pakuptueshme/ kanë qenë pikat, edhe ...këtu ka qenë...është pak problem ...maj thojn....ëëë...se është zgjëru UÇK-ja, ka ec në drejtim të fshatrave,

S.B. ...edhe me shtimin e ushtarëve...

S.B. ...faktikisht në maj nuk di a është lëshuar në Jahur, një fshat afër Kleçkës,

D.B. Më vonë është lëshu edhe në Luzhnicë, por nuk e di, për maj nuk e di a ka qenë edhe atje.

D.B. Po kjo ishte nën...nën përgjegjësinë e Kleçkës?

DRAFT TRANSLATION

S.B. Po, do të thotë ushtarët e Kleçkës që kanë hec përpara. Pastaj ka qenë...

O.L. Ok, yeah, yeah.

S.B. Jahur.

D.B. Ja...

S.B. Jahur.

S.B. Më vonë do të thotë është hec edhe në drejtim të Luzhnicës, është...

D.B. Jen ii sigurtë, ishte në maj apo...në Luzhnicë?

S.B. Maj...nuk...nuk muj me qenë i sigurtë.

S.B. ..por më vonë po.

S.B. Luzhnicë, sigurisht n'maj, në fund të majit ose në fillim të ...ëëë...qershorit.

S.B. Pastaj është Llapushniku. Nuk e di a është në maj apo në qershor, në maj, në fund të majit.

S.B. Llapushnik, pastaj vjen...është Krojmiri...Krojmir. Ëëë....janë zgjëru, nuk e di në Maj a kur, në Petërshticë. Në fund të majit mund të jetë.

S.B. Petërshticë...ëëë...këto fshatrat posht nuk ...posht Kleçkës nuk muj mi mbajt n'mend. /e pakuptueshme/ pastaj ..../?Pushticë/, por më vonë /?Pushtica/.

D.B. Si quhet. Tushicë?

S.B. /?Pushticë/, /Pushticë.

D.B. Fushticë.

S.B. Nejse, kanë qenë tani fshatrat ...janë shumë fshatra. Nekofc e ...ëëë...Kishnarekë... pot e Kishnareka është një tjetër....tjetër..."Pllumbat" janë qujt, një tjetër komandë. Do të thtë, ky përafërsisht është organizimi në...

S.B. Më vonë kemi...kemi shtimin do të thotë të fshatrave, në qershor apo korrik, është shut do të thotë edhe Fushtica,...Blinaja

S.B Është dal edhe n'pjesën tjetër t'asfalltit, të rrugës së Carralevës,

DRAFT TRANSLATION

S.B. ...në fshatin anlt...ëëë...Grejçefc,

S.B. ...edhe është lëshu posht Kleçkës në drejtim të Malishevës dhe faktikisht pastaj Malisheva dikund në qershor /e pakuptueshme/...

S.B. ...në qershor apo korrik ka qenë edhe Malisheva me fshatrat.

S.B. Në Llapushnik kemi pas, do të thotë...ka qenë e vendosur me sa jam...në bazë të informative që ...jozyrtare e dishim,

S.B. ...ka qenë gryka do të thotë e Llapushnikut ku kanë qenë pjesët e ...ëëë...."Çelikut 3" është qujt, edhe një pjesë tjetër e ...ëëë...Drenicës, "Guri 3" më duket.

D.B. Ëëë...përpos Llapushnikut... ëëë....

S.B. Ka qenë në dy pjesë ...

D.B. Ka qenë në dy pjesë?

S.B. Po, do të thotë asfallti...

D.B. Kjo pika qe në dy pjesë e ndarë?

S.B. Në dy pjesë. Do të thotë, ka qenë pjesë ku ka qenë "Çeliku3" dhe "Guri 3".

D.B. "Çeliku 3" dhe 'Guri 3"?

S.B. Po.

D.B. Ishin emra vëndesh që quheshin kështu?

S.B. Emra pikash. Pikë.

D.B. Pikë.

S.B. Është ndarë do të thotë pas vijës së asfalltit.

D.B. Amund...a mund ta vizatoni kështu me diagram siç bëtë këtu...

D.B. ...këto dy pikat...nënpikat e pikës së Llapushnikut.

S.B. ...këtu e ka pas "Çeliku 3" edhe '"Guri 3".

S.B. "Guri 3".

D.B. Kështu që kjo rruga Prishtinë-Pejë i ndante këto dy pika prej njëra tjetrës?

DRAFT TRANSLATION

S.B. Po.

D.B. Thotë cila...si ishte vendndodhja e pikave, do të thotë, në cilën anë të rrugës ishte "Çeliku 3" dhe në cilën anë 'Guri 3"?

S.B. Në pjesën në drejtim të Kleçkës ishte "Çeliku 3", ndërsa...

S.B. ndërsa në pjesën ...ëëë....

S.B. ....në drejtim të Drenicës është "Guri 3".

D.B. E se...siç e përmëndët ...ëëë...me...me kalimin e kohës, gjithnjë e më shumë pika u shtuan në zonë?

S.B. Po.

D.B. Ëëë...me kalimin e kohës, siç e thatë ëëë...me përmëndjen e faktit që këto pikat u shtuan më shumë në rrethinë, a filluan të...të transformoheshin ose të shndëroheshin në ato si...le të themi në...në komanda batalionesh ose në shtabe batalionesh, pika qëndrore dhe pastaj këto pikat e tjera mvartësë si të themi, ishin nën...nën pikat qendrore?

S.B. Ëëë....këto faktikisht janë shëndruar këtu menjëherë pas ofanzivës së parë.

D.B. Pas ofensivës së parë?

S.B. Pas ofanzivës së parë.

S.B. Gjatë kohës të ofanzivës,

S.B. ...unë nga Shtabi i Përgjithshëm jam emëru komandant nënzone. Kështu quhet.

D.B. Komandant nënzonë?

S.B. Po, nënzone.

S.B. Pa de...pa definim të territorit të qartë...

S.B. ...pa definim të strukturës ushtarake...

S.B. ...por pas ofanzivës,

S.B. ...veç ka fillu të definohet...ëëë...të definohet organizimi.

DRAFT TRANSLATION

D.B. Kur flisni për ofenzivën e parë, për cilën ofenzivë e keni fjalën?

S.B. Ofanziva e korrikut. Qershor-korrik.

D.B. Le mos...mos të shkojmë për momentin aq...aq larg.

D.B. A i mbani mwnd ...www...emrat e personave pwrgjegjws pwr kwto pika qw u ngritwn?

S.B. Www...wshtw problem....wshtw problem se informata zyrtare nuk kam mund me...nuk u /e pakuptueshme/.

S.B. Kryesisht me pseudonime e kemi pas edhe...

D.B. Dhe pseudonimet janë në rregull, thotë.

S.B. Ëëë...për shembull këtu është një..."Voglushi"

D.B. "Voglushi" ishte për nën pikë apo për pikë?

S.B. çeto të Llapushnikut "Voglushi' apo 'Qerqizi", nuk e di.

D.B. Për Llapushnikun?

S.B. Për Llapushnik. Do të thotë...

S.B. "Voglushi" faktikisht ka ardh shpesh në Krojmir.

S.B. Edhe na ka ndihmu gjatë ofanzivës, do të thotë, vinte me njësitet ndihmëse.

S.B. Këtë pikë këtu ...ëëë...kanë qenë poashtu ushtarët e...ëëë....e Llapushnikut, në vijë do të thotë, kanë zbritur prej Llapushnikut në /?Fushticë/.

D.B. Shkonin për ndihmë apo ishin të vendosur këtu?

S.B. Jo, jo. U vendosën aty.

S.B. /e pakuptueshme/ që ka qenë lufta për pika e njerëzve...komandantëve të njësive. Kush po bën ma shumë pika!

S.B. Edhe ka qenë shumë problematike.

S.B. Do të thotë se ushtarët e një pike të zbresin në pikën më poshtë se sa...

DRAFT TRANSLATION

S.B. Më shumë përzihej...përzihej puna deri në fillim të ofanzivës. Kur filuan ofanzivat, secili thojke "Jo, jo, unë s'e kam këtë pikë".

S.B. Ëëë....këtu në Fushticë nuk mund ta mbaj mend për shkak të....

S.B. Ëëë....në Petërshticë janë ndëru bukur shumë. Ëëë...janë ndëru këtu bukur shumë. Këtu nuk muj edhe me e ditë...

S.B. Në Krojmir faktikisht ka qenë ...ëëë...vendndodhja e ushtarëve, ku janë grumbullu, ku kanë ardh e janë lajmëru, se Krojmir ka qenë në zonë që...nuk e kanë...kanë /e pakuptueshme/.

S.B. Këtu s'ka pas njësi faktikisht njësi të vendosuna, përveç...

S.B. ...përveç që kam ndejt unë edhe "Luani".

S.B. ...edhe në periudha të caktume.

S.B. Në Luzhnicë jan kon do të thotë prej Kleçkës. Në Kleçkë ka qenë poashtu "Kumanova",

D.B. "Kumanova" ishte për Kleçkën a?

S.B. Ishte nw Kleçkw...

D.B. Ah, ishte nw Kleçkw!

S.B. E kwtu "Kumanova mirrej ma shumw si ...si njeriu hierarkik mw i lartw nw Kleçkw.

D.B. "Kumanova" qwndronte nw Kleçkw?

S.B. Nw Kleçkw.

S.B. Edhe...ndërsa "Çeliku" mirrej...ne e kuptonim kështu apo si njeri ...si njeri i hierarkisë më të lartë, apo njeri ...koordinator me Shtabin e Përgjithshëm.

D.B. "Çeliku"..."Çeliku" mendohej prej jush në atë kohë më lartë se "Kumanova"?

S.B. Më lartë se sa "Kumanova".

DRAFT TRANSLATION

D.B. Kurse "Kuma...Kumanova" mendohej prej jush më i lartë për Kleçkën? Do të thotë personi më...

S.B. "Kumanova"...

D.B. Se mos i bësh gabim, prandaj.

S.B. Jo, jo. "Kumanova"...

D.B. Personi më I lartë përgjegjës në Kleçkë ishte "Kumavanova", sipas mendimit tuaj të asaj kohe?

S.B. Po, ashtu...ashtu mendonim, s'ka pas zyrtare kurgjë.

D.B. Pikërisht atë e thash.

S.B. Eh, tash...

S.B. Më vonë "Kumanova" ka zbrit me njësite, nuk e di a është maji, do të thotë, për çatë e potencova këtë, në Luzhnicë, me njësite....

S.B. ...Javur,

S.B. N'pjesën tjetër të asfalltit në Grejçefc,

S.B. Secili është mundu sa ma...ma gjan me rrokë edhe me kap pika ma shumë, me pas...

D.B. Siç e kuptova unë, "Kumanova" ishte personi më...si të thuash, më...më...përgjegjës më i lartë për Kleçkën por "Çeliku" ishte ...në një farë mënyre ishte më lartë se "Kumanova" në...

D.B. Kjo të paktën ashtu si e kuptova unë nga...nga mënyra e përshkrimit tuaj.

S.B. Ëëë...po, ...

D.B. A është...është e saktë?

S.B. E saktë. "Çelikun" ne e kemi marr do të thotë faktikisht mbi ...mbi organizimin tonë.

D.B. Po edhe "Çeliku" qëndronte në Kleçkë?

DRAFT TRANSLATION

S.B. Po, Po. Në Kleçkë.

S.B. Po në atë periudhë...po në atë periudhë, në Kleçkë, madje edhe në Luzhnicë në periudhë, do të thotë periudha e korrikut apo e fundkorrikut, kanë qëndru edhe një...disa anëtarë tjerë që ne i mermim si anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm.

D.B. Po gjatë këtyre muajve, maj, qershor, korrik, "Çeliku" ishte në Kleçkë do të thotë i pranishëm?

S.B. "Çeliku" aty.

D.B. Ëëë...dëshiroj të qartësoj pak pozitën e "Kumanovës" dhe rolin e tij.

D.B. Ëëë...dëshiroj vetëm të sqaroj këtë pikë: "Kumanova', duke qënë se ishte përgjegjësi...personi përgjegjës më i lartë në Kleçkë, a ishte ai personi që u jepte urdhëra këtyre pikave tjera apo ishte vetëm komandant për...për ushtarët e Kleçkës?

S.B. Ëëë...nuk mund ta dijë. Faktikisht unë, në takimet që unë i kam pas, unë kam pas me "Çelikun".

S.B. Por shpesh në prezencë të "Çelikut" ka qenë edhe "Kumanova".

S.B. Edhe nuk ka qenë forma e urdhnesës, por ka qenë forma e konsultës.

S.B. Do të thotë, faktikisht unë...unë kam marr një konsultim për vijën furnizuese.

D.B. Eh, më fal se bëra gabim.

D.B. Ishte vija furnizuese, jo për armë, sepse unë thash furnizimin me armë.

D.B. Vi jën furnizuese për çfarë?

S.B. Po, po. Me armë.

D.B. Me armë?

S.B. Me armë.

S.B. Edhe ma shumë kanë qenë konsulta; bëne këtë ose mos e bën këtë, do të thotë...e kemi shqyrtu.

DRAFT TRANSLATION

S.B. Kur s'ka mund "Çeliku" me më sqaru, do të thotë faktikisht ka kërku kohë që të konsultohet me anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm.

D.B. A mund ta vizatoni si...kështu si...ëëë....figurë ...ëëë...atë...shigjetën dhe shtabi qëndror, do të thotë që, përmbi...përmbi Kleçkën ishte shtabi qëndror.

D.B. Vetëm për ta plotësuar të gjithë figurën e...ëëë....e strukturës.

S.B. Do të thotë, këtu më vonë, s'e di qershor apo korrik, si ka qenë, nejse, po e shkruj si Shtab i Përgjithshëm këtu edhe pse kam dhënë sqarime shumë ma të...ma të mdhaja këtu...

D.B. Le...të përpiqemi ta qartësojmë dhe njëherë gjithë diagramin.

D.B. Gjatë gjithë këtyre luftimeve që thatë që...ose ofensivave, a është e saktë se ushtarët e të gjithë këtyre pikave përziheshin kështu, nuk...nuk qëndronin në...në pika të caktuara dhe ndihmonin njëri tjetrin ose do të...

D.B. Cila ishte...cila ishte njësia ose qëndra komanduese kur...kur ndodhnin këto gjëra, do të thotë, kur kryheshin luftimet dhe kur ishte nevojë për...për...për të çuar një njësit në ndihmë të pikës tjetër dhe kështu. Kush i organizonte është pyetja?

S.B. Po. Kleçka.

D.B. Si e kishit mënyrën e komunikimit gjatë kësaj kohe?

S.B. Me korier.

D.B. Me korierë?

S.B. N'kam ose vet /e pakuptueshme/

D.B. Nuk kishit telefona e radio në atë kohë a?

S.B. Jo, jo. Ka qenë periudha e parë edhe...nuk kan mund me qenë dy-tri radio lidhje në krejt at terren.

D.B. Në krejt atë terren duke pasur parasysh Kosovën?

S.B. Jo, jo. Në terren të Llapushës, si e qujshim.

DRAFT TRANSLATION

D.B. Po gjatë luftimeve, komandant "Çeliku" a ishte...a ishte i pranishëm në pika të ndryshme, do të thotë, të kësaj...

S.B. Po. Unë që e kam parë do të thotë, ka ardh në luftimet në Carralevë ku kam qenë edhe unë, ka ardh....

S.B. ...drejtpërdrejtë, ose në luftimet në Fushticë,

S.B. Faktikisht ka ardh drejtpërdrejt në luftime.

D.B. Po në intervalet midis luftimeve, do të thotë kur nuk kishte luftime, a...a shkonte nëpër pika, për shembull, a vinte tek ju në Krojmir për t'ju vizituar, për tu pa?

S.B. Po, vinte.

D.B. Pse...pse janë këto emra thotë, këto dy nënpikat – "Çeliku 3" edhe "Guri 3"?

S.B. Ëëë...po faktikisht njësitet që janë organizu në atë kohë janë qujt njësite.

S.B. Edhe kush i ka organizu faktikisht...ëëë..."Çeliku" e ka pas pseudonimin, Fatmiri e ka pas pseudonimin "Çeliku". Në kohën kur i ka grumbullu njerëzit që ka pas detyrë me i organizu, do të thotë i ka grumbullu njerëzit edhe i ka çitur në pika edhe është qujt ...ëëë...njësia e "Çelikut 1", e "Çelikut 2", e "Çelikut ...

D.B. Këto dy nën-njësit në raste se do ti quajmë, ose nënpika u ... u ngritën prej Fatmir Limës?

S.B. Ëëë...në këto luftime ka marr pjesë Fatmir LIMAJ, se kanë qenë luftarë do të thotë edhe të Drenicës, edhe të "Çelikut", do të thotë të Llapushës s ii qujtëm ne, ëëë...në thyerjen e grykës së Llapushnikut apo në marrjen e grykës së Llapushnikut, dhe pastaj janë pozicionu, por "Çeliku" ka qenë këndej ndërsa këtu janë vendos disa ushtarë që kemi pas kanë pas probleme faktikisht edhe me...

D.B. Ajo gjë që do të qartësojë zotnija është që kjo...kjo nën-njësi ose kjo nën-pikë u quajt "Çeliku" sepse u formua prej "Çelikut", u ngrit prej "Çelikut" personalisht?

S.B. Po, disa njerëz do të thotë që u vendosën aty ishin të "Çelikut"

DRAFT TRANSLATION

D.B. Do të thotë u vend...u quajt kështu sepse u formua prej atij?

S.B. U formu, do të thotë ishin ushtarët e "Çelikut".

D.B. Kjo është arsyeja do të thotë që, për derisa...për deri sa ushtarët e Fatmir Limës u vendosën në këtë nën-pikë, prandaj u quajt dhe njësia "Çeliku 3"?

S.B. Po, /?ashtu/.

D.B. D o të bëja...dua t'ju bëja një pyetje në lidhje me atë që përmëndët ju për ofensivën e...e qershorit-korrikut '98.

D.B. Ky...ëëë...e kishit fjalën për luftimet në Carralevë, kjo ofensiva e parë?

S.B Ëëë...po luftimet kanë ndodhur edhe në Carralevë, në të gjitha pikat

D.B. Ëhë, në atë kohë, gjatë ofensivës të parë a?

S.B. Po.

D.B. Po në...në...në çfarë vëndesh tjera veç Carralevës kishte luftime?

S.B. Po ofanziva do të thotë ka fillu në...në pikat e përgjithshme: në Zborc, Carralevë, Blinajë, Fushticë, Llapushnik, në drenicë andej edhe komplet si vijë e ka rrok...

D.B. Kjo...ju e keni fjalën për periudhën qershor-korrik '98?

S.B. Po.

D.B. Ju kur...kur përmëndni ofensivën, do të thotë ju keni fjalën për gjithë këtë varg luftimesh që kryheshin, që ndodhnin në këto pika?

S.B. Po zakonisht ofenzivë ne e kemi qujtun fillimin e operacioneve ushtarake.

S.B. Do të thotë, kur kanë filluar me gjitha aparaturat e tyre, me tankse, me...ëëë...

S.B. Do të thotë, për...për ti thy të gjitha pikat, do të thotë ofanzivë e përgjithshme.

S.B. Ndërsa luftime të kohëpas...të kohëpaskohëshme ka pas edhe më herët edhe në vazhdimsi ka pas,

S.B. ...sidomos në grykë të Carralevës dhe në grykë të Llapushnikut.

DRAFT TRANSLATION

S.B. Kanë qenë dy rrugët që ata i kanë kanë pretendu me i hap aty, se kanë qenë të bllokum,

S.B. Ne i ...

D.B. Këto rrugë ishin të bllokuara prej jush?

S.B. Të bllokuara nga ne. UÇK.

D.B. E di se ka pasur zona e Carralevës në periudhën maj-qershor ...ëëë...luftime përgjatë rrugës Shtim-Dule.

D.B. Kur filloi do të thotë ofensiva, operacionet ushtarake siç e konsideroni ju fillimin e ofensivës? Kur...kur mendoni se filloi?

S.B. Ëëë...po nuk e di datën e saktë por ...ëëë...

D.B. Me përafërsi.

S.B. ....diku në fund të qershorit-fillim i korrikut.

D.B. E siç e thash dhe më parë kur ju thoni ofensivë e parë, ishte vetëm një luftim apo ishin disa luftime, ose si mund ta përkufizoni në kohë, sa zgjati ky...kjo ofenzivë?

S.B. Jo, ofanziva do të thotë është...ëëë...ne me fjalën ofanzivë gjithmonë e kemi përkufizuar veprimin ushtarak në të gjitha pikat, do të thotë me na shtri gjithë njësitë /e pakuptueshme/

S.B. Edhe zakonisht ka pas do të thotë...ëëë...në të gjithë vijën luftime, qoftë fillu prej Carralev-Duhël edhe do të thotë vazhdu në Zborc, Blinajë atje...

S.B. Pastaj ka përfshi edhe zonën e Drenicës,

D.B. Pastaj kush ishte?

S.B. Blinajë, Llapushnik...

S.B. Domethënë, kjo është ofenzivë që e kemi nënkuptu ne, me i thy të gjitha njësitet.

S.B. Aty ka zgjatë diku afërsisht deri në nji muj.

D.B. Në...në lidhje me ofensivën që ju thatë që zgjati përafërsisht një muaj,

DRAFT TRANSLATION

D.B. Gjatë gjithë kësaj periudhe, ju keni qënë sit ë thuash kreu i pikës në ...në...në Krojmir? Gjatë kohëzgjatjes së ofenzivës sigurisht.

S.B. Jo. Faktikisht, në njifarë forme më kanë anashkalu më vonë...

D.B. Gjatë kësaj kohe?

S.B. ....për shkaqe më shumë politike.

S.B. Ëëë...sepse kam fillu të akuzohem...

S.B. ...si njeri që po i tërheq ushtarët nga vija e frontit.

S.B. Më ka ik nga vija e frontit,

S.B. ...dhe unë jam tërhequr nga ...ëëë....të gjitha aktivitetet e mija të tjera. Jam përqëndruar do të thotë në Shtabin e Përgjithshëm...

DRAFT TRANSLATION

D.B. Pas këtij sulmi që filloi ndaj jush.

S.B. Ashtu.

S.B. ...Dhe kam kërkuar ose të mirren masa ndaj meje, do të thotë, të dënohem unë si ai njeri që

S.B. ...që kam tërheq ushtarët nga vija e frontit...

S.B. ...ose të mirren masa ndaj atyre që po përhapin ...

S.B. Dhe në pamundësi që të bëhen këto, ...ëëë...kanë dhënë urdhër që unë të dal jasht Kosovës...

S.B. Do të thotë, kjo ka ndodhë pas shumë konsultimeve që i kam bë në Shtab të Përgjithshëm,

S.B. ...mbenda një periudhe bukur të gjatë

S.B. ...dhe dikur kah mesi i gushtiti apo në fillim t'gushtit, më kanë urdhnu Shtabi i Përgjithshëm që të dal në Shqipëri për të konsolidu pastaj komandën, siç thuhej atje, të nënzonës operative të Nerodimes.

D.B. Të Nerodimes?

D.B. Mund të ma përshkruani dhe një herë detyrën, domethënë, u urdhëruat nga Shtabi i Përgjithshëm për të shkuar në Shqipëri...

S.B. Për të konsoliduar...po...

D.B. Për të konsoliduar çfarë?

S.B. Nën-zonën ...ëëë...komandën e nën-zonës...

S.B. ....dhe për të shiqu vijën e furnizimit me armë.

S.B. Faktikisht ajo periudhë e ozanzivës t'parë ka qenë një periudhë që mu më ka godit bukur shumë,

S.B. ....sepse detyra ime ka qenë e padefinume.

S.B. M'kanë thënë koordinator një kohë...

S.B. ....e ma vonë më kanë emru si komandant nën-zone,

S.B. /e pakuptueshme/ do të thotë si nënzona operative e Nerodimes, me...me kalu në atë nënzonë.

S.B. Në mungesë të radio lidhjeve, nuk dihej se në cilin vend jam. Faktikisht, shkojsha në luftime në...që ishin të t'njejtës kohë në Blinaj, këta të Zborcit ishin /e pakuptueshme/ .

D.B. Kush...kush ju ka akuzuar për këtë...braktisje ose për këtë që po i merr ushtarët prej ...

S.B. Kryesisht komandantët e pikave.

D.B. Komandantët tjerë të pikave?

S.B. Po. Komandantët e pikave që kanë qenë të vendosun...

D.B. Dhe kur thatë se shkuat në shtabin kryesor për ta sqaruar do të thotë që, o të merreshin masa kundër jush ose kundër tyre, ju kishit parasysh ju shkuat në Kleçkë apo shkuat në SHtabin Qëndror?

DRAFT TRANSLATION

S.B. Po faktikisht n;atë kohë ishin disa anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm, do të thotë në fund të ofanzivës veç u panë se kush janë, e dishim përafërsisht se kush janë..anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm...

D.B. Po ku ishin ata?

S.B. Ata ishin në Luzhnicë.

D..B Në Luzhnicë.

D.B. Fundi i korrikut thatë ju apo jo?

S.B. Në fund të korrikut - fillim të gushtit.

S.B. Po fundi korrikut...

D.B. A keni biseduar me "Çelikun" për këtë punë?

S.B. po, normal që kam biseduar edhe me "Çelikun".

D.B. "Çeliku"..."Çeliku" ju caktoi për me....ëëë...për me shku në Shqipëri që të merreshit me punën me konsolidimin, me konsolidimin e komandës së nën-zonës dhe me...

S.B. Jo, jo. Do të thotë anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm. Kanë qenë anëtarë... pesë anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm.

S.B. Do të thotë ka qenë ajo që ishte publike, atë që e dinim qartë se kush është, ka qenë Jakup KRASNIQI.

S.B. E ai do tw thotw ka qenw njeriu qw kam njoft /?ma pwrgjegjws/.

D.B. "Çeliku", meqenëse ishte personi kryesor në...në atë zonë aty, çfarq qëndrimi mbajti ai ndaj...ndaj këtyre akuzave që u lëshuan kundër jush?

S.B. Ëëë..."Çeliku"... faktikisht "Çeliku" dhe të tjerët fillimisht i kanë marr ...ëëë... shumë jo....jo në kuptimin serioz të peshës që kishin ato...ato thashethëmet....

D.B. Nuk e morrën shumë seriozisht atë....

S.B. Nuk e morrën seriozisht...

DRAFT TRANSLATION

S.B. ...dhe kur unë jam tërhequr në Luzhnicë...

S.B. ...dhe kam kërkuar sqarime...

S.B. ....dhe defi...definim të pozitës time...

S.B. ....ëëë....thjeshtë nuk më kan këthy përgjigje.

S.B. Ëëë...pas një kohe u goditën edhe të tjerët

D.B. U goditën do të thotë u akuzuan?

S.B. Po do të thotë, në të njejtën formë, thashethëmje e dezinformata.

S.B. Dhe kuptun se ishin vetëm dezinformata, mirëpo, në pamundësi që të veprojë diçka më /?nxjerën në Shqipëri/.

D.B. Po çfarë...çfarë keni bërë faktikisht gjatë qershor-korrikut '98? Çfarë pozite keni pasur ju?

S.B. Unë kam qenë i emrum komandant nën-zone.

D.B. A ishte kjo...mbulonte një...një zonë të caktuar kjo...kjo nën-zonë?

S.B. Po faktikisht ishte nën-zona operative e Nerodimes.

S.B. Faktikisht unë duhej të kaloja në atë pjesën ku duhej të komandoja.

S.B. Mirëpo kam mbetur gjatë ofanzivës ...kam mbetur në atë teritor,

D.B. Në...në cilin teritor?

S.B. Në teritorin Kleçkë....

S.B. ...edhe nuk kam dasht të shkoj t'a ushtroj detyrën time në pjesën ...ëëë...që e ka rrokë nën-zonën operative të Nerodimes, do të thotë Ferizaj, Kaçanik e kështu.

D.B. Nuk keni dashur ju apo nuk mundnit..

S.B. Nuk kam...nuk kam dashur unë.

D.B. Nuk keni dashur, aha.

S.B. Pikërisht për shkak të mosqarimeve të...

S.B. Dhe kam kërku edhe definimin e pozitës time.



DRAFT TRANSLATION

S.B. Edhe faktikisht, unë kam marr pjesë në luftime,

S.B. ...kam ndihmu komandantin e nën-zonës që u emru në atë kohë..ëëë...

D.B. E cilës nën-zonë? Kësaj....

S.B. Zonës të Pashtrikut.

S.B. Musë...Musa Jasharin.

S.B. Hupi nga njëherë. Ëëë...kam ndihmu në konsolidimin e çrregullimit të ushtarëve në nën-zonën e Pashtrikut.

D.B. Kështu që të ketë organizim më të mirë?

S.B. Do të thotë me u....me i tubu ushtarët se u /e pakuptueshme/.

S.B. Kjo ka qenë ndihmë pa më ngarku askush.

S.B. Kam shku në 122 më vonë, territory i Malishevës andej,

D.B. E çfarë është 122?

S.B. Më vonë Brigada 122 e Pashtrikut.

S.B. Edhe kam kry punë, do të thotë që faktikisht s'më ka ngarku askush.

S.B. Po kryesisht kam qenë në Shtab të Përgjithshëm.

D.B. Keni qëndruar aty në...në rrethinë të Krojmir apo keni lëvizur në..në të gjithë zonën që...ëëë...ishte nën komandën e Kleçkës?

S.B. Në Krojmir kam qëndruar deri në fillim të ofanzivës...periudha e qershorit...

S.B. Dhe momenti kur ka fillu ajo propagandë ka qenë rreziku me më vra vet ushtarët...

S.B. ...dhe jam tërhequr do të thotë në Luzhnicë.

S.B. Luzhnicë.

S.B. Në Luzhnicë dhe...ëëë...më vonë do të thotë kam shku me Musa Jasharin prej ...ëëë... një vendi në vendin tjetër, aty diku pesë-gjashtë ditë me...me thënë, po /e pakuptueshme/

DRAFT TRANSLATION

S.B. Dhe Shtabi i Përgjithshëm domethënë në fund të korrikut, një – dy gusht ka mund të jetë, ...ëëë...më ka lajmëru se duhet të nisem për Shqipëri.

S.B. Ëëë...fillimin e rrugës, do të thotë faktikisht nuk e kam bë për shkak të dëshirës edhe të "Kumanovës",komandant "Kumanovës" të vijë bashk me mu në Shqipëri.

D.B. Do të thotë, ju kishit dëshirë që...

S.B. Jo, "Kumanova" kishte dëshirë të nisej për Shqipëri edhe ai...

S.B. ...edhe kemi pritur edhe disa ditë, edhe tri ditë apo katër,

S.B. ...www...kur edhe ka ndodhw pastaj vrasja e njwrit nga shokwt e mi mw tw ngushtw, Agim Bajramit,

S.B. ...dhe ndalimi im për një kohë që të shkoj të ...në Jezerc...do të thotë urdhëri për të shku në Jezerc nga Shtabi i Përgjithshëm.

D.B. Kështu që u /?skadua/ urdhëri do të thotë për shkak të kësaj?

S.B. Nuk u /?sfendu/ por ë shkoj për dy-tri ditë në Jezerc...

D.B. Në Jezerc?

S.B. Në Jezerc të Ferizajit.

S.B. Porn ë pamundësi që të depërtoj në anën tjetër...

D.B. Në Shqipëri do të thotë?

S.B. ...u nisëm për në Shqipëri.

S.B. Jo, në anën tjetër, në Jezerc të shkoj.

D.B. Aha.

S.B. U nisa për Shqipëri.

D.B. Dëshiron të saktësojë një gjë zotnija, megjithëse unë ja sqarova, thotë, ëëë...ju na thatë se pasi morët emrimin si komandant i nën-zonës të Nerodimes, ju nuk mund të shkonit atje për shkak të ofenzivës apo ju nuk...nuk kishit dëshirë të shkonit atje për shkak të keqkuptimeve që...



DRAFT TRANSLATION

S.B. Jo për shkak të ofanzivës, se depërtimi i maleve ka qenë i mundshëm, por për shkak...

S.B. ...por për shkak se fillun propagandat kundër meje...

S.B. ....pikërisht sepse isha emëru komandant i ...i nën-zonës.

S.B. ...dhe në pjesmarjen e luftimeve të atyre ditëve, sapo isha emëru do të thotë komandant nën-zone, ishte e pa definume, do të thotë, as...

S.B. As vetë nuk e dija kënd kam me e komandu n'atë zonë...

S.B. /e pakuptueshme/

D.B. Ëëë...unë vetëm dua të saktësoj se thotë kur ...kur...kur jeni emëruar në atë detyrë?

D.B. Ishte në qershor kur...kur jeni emëruar?

S.B. në qershor. Qershor.

D.B. Gjatë këtyre luftimeve në qershor dhe në korrik, a mund...a mund të thoni se ju ishit nën...nën komandën e "Çelikut"? Do të thotë si...si...si hier...si hierarki?

S.B. Jo, nuk kam qenë nën komandë të "Çelikut". Do të thotë, në qershor, faktikisht kam qenë...

S.B. ...nën urdhnat e Shtabit të Përgjithshëm.

S.B. Për shkak se pastaj ishte...ishte një...njifarë forme e definume, ma e definume....ma e definume komanda.

D.B. Le...le të qëndrojmë këtu në qershor-korrik do të thotë.

S.B. Po. Po pikërisht në qershor-korrik fillun të definohen ...

S.B. ...ashtu që Shtabi i Përgjithshëm...

S.B. ...që nuk njihen n'atë kohë njerëzit, po Jakup KRASNIQI njifej,

S.B. Ishin...ëëë...nën-zonat;

S.B. ...nën-zonat operative.

DRAFT TRANSLATION

S.B. Do të thotë, nuk e kemi ditë na, apo unë nuk e kam ditë së paku, sa....sa nën-zona do të jenë...

S.B. Por, nën-zona ku jam emru unë komandant është qujtun nën-zona operative e Nerodimes.

S.B. Unë jam ngarku si komandant i nën-zonës ...

S.B. ...për të organizu shtabin.

D.B. Për të organizuar shtabin?

S.B. Shtabin dhe luftën e nën-zonës operative të Nerodimes.

S.B. Do të thotë, përafërsisht diheshin tash struktura, në qershor-korrik...

S.B. Do të thotë, dihej Shtabi i Përgjithshëm, diheshin nën-zonat.

S.B. Edhe na kishin dhënë udhëzime se si do të ...ëëë...si mund të organizohet shtabi i zonës, si do të organizoheshin njësitë...

S.B. ...por, si komandant nën-zone kur jam emru, nuk e kasha të definum teritorin.

S.B. Quhej nën-zona operative e Nerodimes,

S.B. ...nuk dihej a do të jetë teritori i Kaçanikut dhe Elezhanit në atë nënzonë,

D.B. Edhe Ferizaj?

S.B. Kaçaniku...Kaçaniku dhe Elezhani, do të thotë.

D.B. Edhe Elezhani?

S.B. Elezhani, po.

D.B. Han ii Elezit, po.

S.B. Po.

S.B. Dihej që Shtimja dhe Ferizaji do të jenë në atë nënzonë,

S.B. Nuk dihej Lipjani në cilën nënzonë do të bijë.

S.B. Kjo është definu do të thotë dikund...ëëë....kah fund ii tetorit.

S.B. Do të thotë pastaj, kur është definu, do të thotë unë jam këthy prap në Kosovë.



DRAFT TRANSLATION

D.B. Më fal që ju...që po këthehem përsëri mbrapsht...

S.B. Jo, s'ka gjë. Këthehu sa herë të dush.

D.B. Do të thotë që ishte në qershor që ju morrët emërimin si komandant i nënzonës operative të Nerodimes?

D.B. Po për ...për arsyet që ne...ju i përmëndët më parë, ju refuzuat ta merrnit detyrën dhe qëndruat në atë...në atë zonë që e pqrshkruat ku qëndruat.

D.B. Kjo do të thotë që ju nuk...nuk merrnit urdhëra prej "Çelikut" i cili ishte komandanti i asaj zone aty.

S.B. Jo. Urdhna kam marr vetëm në momente kur...jo nga "Çeliku", por kur kam qenë në njësi. Në qoftë se kam qenë në luftime shembull në Blinajë, unë kam marr urdhna do të thotë në Blinajë. Kur kam marr pjesë atëherë në njësitet, në këto njësite, unë kam marr urdhna nga çata që kanë qenë aty.

D.B. Përsëri ju ishit i detyruar në një mënyrë që të nqiqnit...ëëë...që të përcillnit, të zbatonit atë strukturën e urdhërave që vinin le të themi nga Kleçka te pika e komandantimit dhe komandanti i pikës së komandimit pastaj do t'i përcillte këto urdhëra me që...

S.B. Po, po. Patjetër. Në qoftë se kam qenë në teritor të...ëëë...të...atyre njësiteve, është dash me i zbatu urdhnesat.

S.B. Në qoftë se kam qenë në teritor të Malishevës atje, do të thotë faktikisht është dash me i zbatu urdhnesat e...ëëë...e Pashtrikut.

S.B. Po faktikisht isha i padefinum më. Kjo ka ndodhë do të thotë prej kohës...do të thotë qershor kur veç është marr vesh...

S.B. Unë jam emëru komandant nënzone edhe dikush ka tentu të

S.B. S'i ka pëlqy thjeshtë, s'i ka pëlqy që jam emru.

DRAFT TRANSLATION

S.B. Deri në ato momente kam mund të kem edhe...edhe autoritetin...autoritetin te ushtarët.

D.B. Kur keni shkuar, kur keni marr pjesë rastësisht në...në këto luftime në...në...në pika të ndryshme, a ju...ju caktonte dikush të shkoni apo shkonit vetë me dëshirën tuaj?

S.B. Ëëë...jo, zakonisht ne edhe më herët kemi shku. Në rastë se kamë pëlcit luftimet në grykë të Carralevës edhe kemi ndëgju luftime, ne kemi shku në...në ndihmë të tyre, do të thotë, pa ndonjë urdhnesë të veçantë. Në rastë se një pikë ka pas një...ne e kemi pas si strategji lufte, në qoftë se mund të quhet nga tash, se atëherë se kemi qujt, ëëë...kemi shku në ndihmë të njëni tjetrit. Në qoftë se ka pëlcit në një pikë luftimi, na kemi shku, pavarësisht asaj.

DRAFT TRANSLATION

D.B. Kur thoni...kur thoni ne, për...çfarë...çfarë keni parasysh?

S.B. Po ne, do të thotë unë, ushtarët që kemi qenë aty, do të thotë, si kanë pëlcit luftimet, kam qenë në tre-kater ushtarë a pesë. Edhe anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm kanë ardh.

S.B. E di...e di që e keni shumë vështirë m'i kapë këto,

S.B. ....sepse edhe unë në atë kohë as që kam mujt me i .../e pakuptueshme/

D.B Është ora 1215.

D.B. Do të bëjmë një pushim edhe do të...do të ulemi pak jashtë.

DRAFT TRANSLATION

D.B. Koha sipas orës sime është 1250...

D.B. ...dhe do të vazhdojmë me intervistën.

D.B. A jeni dakord...pajtoheni që të vazhdojmë me intervistën?

S.B. Sigurisht.

D.B. A...në këtë moment, a keni ndonjë pyetje?

S.B. Jo.

D.B. Para se...ëëë...me filluar pushimin ne po flisnjim për...ëëë...periudhën qershor-korrik '98.

D.B. ...që ishte nën...nën komandën e Kleçkës.

D.B. Këtë periudhë kohore ju e përshkruat se...si...ëëë... ofenziva e parë.

D.B. Para ose gjatë kësaj ofenzive, ju na përshkruat, na përmëndët rastin që... ëëë...pati akuza kundër jush në kohën që ju u emëruat komandant i nënzonës së Nerodimes.

D.B. Arsyet pakashumë na u spjeguan prej jush për këtë...ëëë...për këtë punë edhe nuk ka...ëëë...unë nuk shoh ndonjë arsye që ne të vazhdojmë të shkojmë hollësira për këtë punë.

D.B. Dëshiroj...

D.B. Dëshiroj t'ju tregoj një hartë e cila është e numërtuar U0033371.

D.B. Kjo është një...ëëë....siç e shikoni një hartë me...me...me kufitë e...e të ashtuquajturave...e të ashtuquajturave nënzona operative të UÇK-së.

D.B. A e njihni kështu si hartë? A e njihni pamjen në....në...në hartë?

D.B. Kur mund t'a përcaktoni si kohë, do të thotë kur ka ndodhur kjo ndarje organizative në...në nënzona?

DRAFT TRANSLATION

S.B. Kjo në nënzona është ëëë...t'a kqyri. Do të thotë, është faktikisht këtu në fund të tetorit kur edhe kemi kalu në zona. Faktikisht nuk ka qenë nënzonë më. Me një urdhnesë...

D.B. N'fund të tetorit është kaluar në zona?

S.B. N'fund të tetorit, n'fillim të nëntorit, do të thotë na o lëshu...na u ka lëshu urdhnesa si...ëëëë....komandë, t'jemi si komandë e zonës edhe janë definu pastaj edhe kufitë.

D.B. Ëhë. Gjatë kohës që ju ishit emëruar si komandant i nënzonës së Nerodimes, a ishte ky pjesë e një procesi të vazhdueshëm që Kosova po ndahej në nënzona ose më vonë në zona ope...operative?

S.B. Po ashtu...ëëë...ashtu nga sot e shoh. Prej sot e shoh ashtu.

D.B. A ishte ...ëëë...active, do të thotë, a ishte operative zona e Nerodimes në kohën që ju u emëruat komandant i saj?

S.B. Ëëë...jo, periudha tetor-nëntor...

D.B. Ose, në rastë se do ta vendosim në shqip më mirë, a ishte formuar gjatë kohës që ju u...u emëruat komandant i saj?

S.B. Jo, në periudhat e nëntorit, komplet nëntori, dhe n'fillim dhjetorit ka qenë periudha e konsolidimit të shtabit të zonës....e komandës së zonës.

D.B. Por në qershor '98 kur ju jeni emëruar, a ishte zona operative?

S.B. Jo, nënzonë ishte, nënzonë.

S.B. ...e definume por pa ëëë...pa organizim.

S.B. Faktikisht kishte njësite,

S.B. ..në Ranc,

S.B. Jezerc,

DRAFT TRANSLATION

S.B. ...dhe në Kaçanik, por ende të pa dalun publikisht, të pa pozicionum, veç ishin...njifeshin njerëz.

S.B. Faktikisht ishte korriku kur kanë fillu t'vendosen njësitet e para në...ëëë...atë pjesë.

D.B. Që kanë filluar të kenë pikat e tyre, ë?

S.B. Po.

S.B. Ëëë...do të thotë, unë isha ngarku që të kaloj n'atë pjesë, që të kordinoj punën dhe të bëj shtabin e nënzonës.

S.B. Mirëpo, ishin të pa definume shumë çka.

D.B. Përsëri dëshiroj t'I kthehem kësaj periudhës qershor-korrik '98.

D.B. Edhe kjo...ëëë...rrethina që ishte nën...nën komandën e Kleçkës.

D.B. Kjo...ëë...diagram që e keni vizatuar, a ishte efektive, a ishte praktike në realitet në kohën që ju e quani ofenziva e parë? Do të thotë kështu si ...si e përshkruat ju në vizatim?

S.B. Po, po. Kanë qenë pikat t'vendosuna.

D.B. Edhe përafërsisht ky ishte organizimi nën...nën autoritetin ose nën komandën e Kleçkës?

S.B. Ashtu si...

D.B. Po flasim...

S.B. ...e kishim ne të kuptume.

D.B. Si...si ndodhi kjo pastaj, thotë, si...si...ëëë...do të thotë...ëëë...si ishte procesi i zvi...zhvillimit, i transformimit, kur filloi kjo ndarja e zonave edhe ëëë...përcaktimi i kufive? Çfarë ndodhi me këtë...me këtë ëëë...organizim të vogël këtu?

S.B. Ëëë...ky organizim faktikisht menjëherë pas ofanzives...ëëë...kanë qenë ushtarët shumë të çorjentum.



DRAFT TRANSLATION

S.B. ….dhe shumë ka pas popullatë …në…në atë pjesë dhe...ëëë…është tubu domethënë n'Kleçkë organizimi

D.B. Kështu popullatë civile, të ikur nga lufta, për atë e keni?

S.B. Po, po.

S.B. …dhe është urdhnu një farë reorganizim në njësia.

S.B. N'atë kohë do të thotë është, kur jut hash edhe ma herët, ka fillu të definohet ëëë…se çka do të bëjmë, çfarë strukture.

S.B. Do të thotë, ka qenë n'fillim t'gushtit…

S.B. …kur të t'gjitha pikave…njerëzit e t'gjitha pikave, janë tubu dhe ëëë…kanë…kanë formu brigadën e 121.

D.B. 121?

S.B. 121.

S.B. Do të thotë sepse… n'atë kohë do të thotë edhe kishim ëëë…e kishin komandantin e nënzonës Musa Jasharin.

D.B. Që mbulonte këtë…Kleçkën?

S.B. Që mbulonte krejt…krejt Pashtrikun.

D.B. Ëhë. Ai u caktua komandant brigade apo …?

S.B. Jo, komandant i ëëë…i nënzonës operative të Pashtrikut.

S.B. E këto futen…do të thotë bëhet brigade 121.

D.B. Njerëzit prej këtyre pikave formuan…

S.B. Prej këtyre pikave formohet brigade e 121.

D.B. Atëherë ju...ëëë…doni të thoni që ky…ky ëëë…prej këtij organizimi këtu...ëëë…doli ajo që u quajt brigade e 121?

S.B. Ëëë…po. Do të thotë, t'gjitha këto pika, ka pas edhe pika tjera që më vonë janë /e pakuptueshme/…

DRAFT TRANSLATION

S.B. ...edhe janë grumbullu, domethënë...ëëë...të gjithë ushtarët në brigadën 121.

D.B. Për...për arsye të qartësisë së incizimit,

D.B. ...Zoti Buja...ëëë...po i referohet...po tregon diagramën e parë që e vizatoi për ne.

D.B. ...e cila do të shënohet me numrin "diagrama një".

D.B. Kjo brigade 121 ishte pjesë e...ëëë...nënzonës së Pashtrikut, a është e saktë kjo?

S.B. Po.

D.B. Por para...para kësaj, do të thotë, para formimit të brigadës 121,...ëëë...nënzona e Pashtrikut ishte egzistute...ëëë...egzistuese, do të thotë vepronte?

S.B. Ëëë...jo. Do të thotë, në të njëjtën periudhë ka qenë, ëëë...qershor apo korrik,

S.B. Fillimisht janë emru vetëm komandantët e nënzonave,

S.B. ...pastaj gjatë ofanzivës nuk kanë pas kohë as t'mirren me këtë punë,

S.B. ...edhe menjëherë pas ofanzivës

S.B. ëëë...ka fillu do të thotë punën...ëëë...Musa Jashari, që ka qenë komandant i ...ëëë...nënzonës /e pakuptueshme/ t'Pashtrikut, i emërum n'qershor.

S.B. ...dhe është definu, do të thotë nga shtabi i përgjithshëm, që duhen t'organizohen brigadat.

S.B. Faktikisht nënzona e Pashtrikut ka pas disa brigada.

S.B. Nëse ju kujtohet kur fola për ndihmën që ja dhash komandantit të nënzonës operative të Pashtrikut, Musa Jasharit,

S.B. Faktikisht ishte ndihma që u dhoke në këtë organizim.

S.B. Ishte njëkohësisht fitim i përvojës se si organizohen ëëë...këto njësitë.

D.B. Si mendoni ju? Sipas vlerësimit tuaj, a...a janë të saktë kufitë që definohen në zonën e...e Pashtrikut?

S.B. Ëëë....po shiqo, kanë shku me rrugë pak a shumë.

DRAFT TRANSLATION

S.B. Ëëë...kjo është faktikisht rruga...ëëë...rruga që lidhë Prishtinën me...me ëëë...Pejën.

S.B. Ka qenë rruga që ka ndarë zonën e Drenicës me...ëëë...zonën e Pashtrikut.

S.B. Kjo pjesë do të thotë përafërsisht është...ëëë...është n'rregull.

S.B. Mund t'ju flas për...ëëë...zonën më vonë, timen.

S.B. Faktikisht, zona është definu kështu, si...si është këtu,

S.B. ...me përjashtime...

S.B. ...se kemi pas shumë pshtjellim, brigada e 121 me 161,

S.B. ...sepse një pjesë e brigadës 121 ka qenë n'territor t'komunës së Lipjanit,

S.B. ëëë...poashtu edhe brigade 161 do të thotë ka pas përgjegjësi poashtu të një pjese të Lipjanit.

S.B. Do të thotë prap është lënë ajo /e pakuptueshme/ gjithmonë e padefinimit të qartë.

S.B. Mirëpo s'ëm ka pengu shumë...

S.B. ...se kontrolli i njësiteve, apo i brigadës 161 edhe 162 ishte bukur i qartë, i terrenit do të thotë që e kontrollonim, nuk kishte qytete si Lipjani ëëë...Shtimja e Ferizaji...

D.B. Brigada e 161?

S.B. 61.

D.B. Edhe 62, edhe 162?

S.B. 161 edhe 162.

S.B. Edhe faktikisht, kjo është periudhë e mëvonëshme.

D.B. Kur...kur u emëruat komandant i..nënzonës për Nerodime, në...në qershor,

D.B. A mendoni se ishte...a mendoni se ishte planifikuar ndarja në atë kohë që jeni emëruar ju komandant i nënzonës? Ndarja në kufi kështu...

DRAFT TRANSLATION

S.B. Ëëëë...nuk...nuk e besoj për shkak se edhe kam kërku sqarime në atë kohë. S'më janë dhënë do të thotë...

S.B. Edhe ndarja...edhe ndarja që është këtu do të thotë, ka...ka gabime.

D.B. N'atë kohë që jeni emëruar ju, a e dini kush...nëse është emëruar kush si komandant nënzone për Pashtrikun?

S.B. N'atë kohë do ë thotë është emru Musa Jashari si komandant nënzone.

D.B. Në qershor?

S.B. Në qershor.

D.B. Kjo është struktura e parë që...

D.B. Kjo më vonë u shndërua në brigadën 121.

S.B. Po, pas...

D.B. Do të thotë u transformua në brigadën 121.

S.B. Po.

D.B. Edhe në deklaratën e parë origjinale që i keni dhënë zyrës së prokurorisë keni thënë që brigade 121 u formua gjatë ofenzivës t'sërbëve në korrik të '98. A është e saktë?

S.B. Po mund të llogaritet edhe si fundi i ofanzivës. Faktikisht ka qënë... se nuk e di periudhën tamon me datë edhe me ....

S.B. Kur...kur ka përfundu ofanziva.

S.B. Po faktikisht është periudha e përfundimit t'ofanzivës.

D.B. Edhe Shtabi i 121 ishte në Kleçkë?

S.B. N'Kleçkë është.

D.B. Kështu që kjo...ky shtab që e përshkruam në diagramën një i strukturës ushtarake më vonë u bë shtabi I brigadës 121?

S.B. Po.

DRAFT TRANSLATION

D.B. Dhe Fatmir Limaj vazhdoi t'ishte komandant do të thotë i...

S.B. Po, me sa...me sa jamë n'dijeni unë.

S.B. Do të thotë, faktikisht n'atë ...

S.B. ...periudhë unë veç une jam nis në drejtim të Shqipërisë.

S.B. Ka qen i emrum komandant i brigadës.

S.B. Për mu ka qen pak një habi,

S.B. ...sepse unë e kam marr Fatmir Limën si antar t'shtabit të përgjithshëm.

S.B. Edhe, ai të jetë një komandant brigade...edhe për mu ka qenë e pakapshme.

D.B. Porn me njëfarë kuptimi kjo është rrjedha...rrjedha normale dhe natyrale e gjërave, që kjo strukturë pastaj u...ëëë...evolvoi në brigadë?

S.B. Në brigadë, po.

S.B. Siç është bërë e qartë dhe në intervistën e sotme,

D.B. Periudha kohore për të cilën ne jemi...ne jemi më së shumti të interesuar është...ëëë...qershor-korrik, domethënë pranverë-verë 1998.

D.B. Ne kemi kryer shumë hetime dhe kemi...kemi biseduar me shumë njerëz.

D.B. Kanë qënë dëshmim...në...në cilësinë e dëshmimtarit ose të dyshuarit ose ekspert edhe...e tjera.

D.B. Ka njerëz që nuk kanë da...shumë dëshirë për të folur me ne për një arsye ose për një arsye tjetër,

D.B. ...ndërsa ka tjerë që flasin më..më hapur, më...më sinqerisht me ne.

D.B. Ne i kemi mbledhur gjithë këto informata me qëllim që të krijojmë një pamje më të qartë në lidhje me të gjithë...ëëë...periudhën kohore për të cilën flasim.

D.B. Ne...ëëë...siç e kuptojmë dhe nga biseda me...ëëë...lufta vazhdonte dhe në...në kohë lufte gjithmonë gjërat janë të...të ndërlikuara, të ngatërruara.

DRAFT TRANSLATION

D.B. Edhe sigurisht që ju zhvillonit një luftë kundër sërbëve për...për lirinë e njerëzve edhe për lirinë e vendit tuaj.

D.B. Por, fakti është se ndodhën gjëra gjatë kësaj kohe në..në zonë që nuk janë të justifikueshme me nga...thjeshtë nga pikëpamja se ishte kohë lufte.

D.B. Dëshiroj t'ju jap disa shembuj.

D.B. Për shembull,

D.B. ...njerëzit që konsideroheshin si bashkëpunëtorë t'sërbëve janë arest...janë arestuar prej UÇK-së.

D.B. Në...natyrisht që në një gjendje lufte kjo është...kjo është e natyrshme.

D.B. Po këto arestime dhe këto rrëmbime pastaj çuan në gjëra tjera të cilat nuk ishin më të justifikueshme.

D.B. Gjatë këtyre incidenteve që lidhen me këto që i përmënda unë, disa herë ka dalë edhe emir juaj,

D.B. A mund...

D.B. A mund të na thoni nëse keni marr pjesë në arestimin e njerëzve të cilët konsideroheshin si bashkëpunëtorë të sërbëve?

S.B. Drejtëpërdrejtë jo a!

S.B. Mund t'ju argumentoj që kam marr pjesë në...marrjen e armëve,

D.B. Në marrjen e armëve në ç'kuptim?

S.B. Në marrjen e armëve. Do të thotë, ata që kemi pas informata se kanë armë,...

S.B. ...për shembull, siç është rasti në Magure...

S.B. ...kur e kemi marr një pushkë edhe një ëëë...revole.

S.B. Poashtu në rastet kur ëëë...n'grykë të Carralevës,

S.B. kam marr, po i përmend rastet, kam marr një...ëëë...automjet me gjithë personin që voziste.

DRAFT TRANSLATION

S.B. Ishte i ndihmës së shpejtë.

S.B. ...por ai, edhe pse është frigu, edhe pse ka mendu që është arestu, ëëë...

S.B. ...faktikisht ai të njejtën ditë është liru sepse nuk ka qenë qëllimi te personi por te kerri.

S.B. Apo rasti tjetër që e kam marr një djal shtatëmbëdhjetë vjeçar,

S.B. ...serb.

S.B. ...dhe ëëë...më vonë është liru,

S.B. Sot është polic në ëëë...Lipjan.

S.B. Ëëë...por raste të arestimeve,

S.B. ...ka pasur,

S.B. ...edhe madje periudha më e rëndë...

S.B. ëëë...ka qenë pikërisht qershor-korriku,

S.B. ëëë...sepse ka pas...ka pas raste që unë nuk mund të flas me emër dhe mbiemër,

S.B. ...sepse nuk i di,

S.B. ...por mund të flas që ka pas edhe hakmarrje individuale.

S.B. Ka pas edhe...

S.B. Ka pas hapsirë të mjaftushme për të bë veprime të tilla.

S.B. ...ëëë...për shkak, do të thotë,ëëë... veprimet t'njësiteve shumë të shpërndara

S.B. Por unë nuk kam pranu që t'bëj ndonjë burg, apo ndonjë vendndalim,

D.B. Ëëë...që të bësh në ç'luptim? Që ta ngresh?

S.B. Që ta...t'a bëj, t'a caktoj një lokacion më thon këtu...

S.B. ...sepse nuk e kam ndi veten as kompetent,

S.B. dhe as njëri që kam ditë informacione.

S.B. ...dhe kur kam ndodhë me nji arestim...

S.B. ...dhe kur jam pyetur se "çka...çka të bëj"

DRAFT TRANSLATION

S.B. thjeshtë kam thënë "nise për në Kleçkë, apo", do të thotë faktikisht në Kleçkë ne i kemi orjentu se s'kam dit diku tjetër,

S.B. ...për shkak edhe t'asaj se s'kam qen do të thotë njeri që mu ka caktu përgjegjësia e ..e punës.

D.B. Do t'a ndërpresim incizimin për shkak se mbaroi videokaseta dhe do t'a ndërojmë.

D.B. ...dhe koha sipas orës sime është 1317.

DRAFT TRANSLATION

D.B. Koha sipas orës sime është 13:18.

D.B. Ne e ndryshuam videokasetën dhe tani do të vazhdojmë intervistën.

D.B: Unë e kuptova nga...nga përshkrimi juaj mbi...mbi pjesëmarrjen tuaj të kufizuar ose të paktë në të gjthë ....gjithë këto histori.

D.B. Dhe këtu unë e kam fjalën për këto...për rrëmbimet.

D.B. Por ju ishit i vetëdijshëm për faktin se shumë individë, do të thot, shqiptarë dhe sërb, po.....po rrëmbeheshin në atë kohë...

D.B. ...edhe...edhe pse ju vetë nuk ishit ai që morrët pjesë në këto rrëmbime.

D.B. Dhe ju jeni të vetëdijshëm edhe për faktin që u rrëmbyen edhe sërb?

S.B. /e pakuptueshme/ unë mund t'a përshkruaj rastin tim. Nuk mund të....

S.B. Nuk mund të flas për rrëmbimet e civilëvë sërb, por aty ku...ku e kam pa drejtëpërdrejtë, aty kam intervenu.

D.B. Por ju keni ndëgjuar për rastet sërbë që janë rrëmbyer edhe pse ju vetë nuk keni qënë i pranishëm ..., që e keni...nuk keni qënë i pranishëm, nuk keni përjetuar ose nuk keni marr pjesë në to? Do të thotë, që vetëm I keni dëgjuar pavarësisht se nuk keni qënë...

S.B. Zakonisht është /? mase /e pakuptueshme/ zënë/, do të thotë ushtarak ose njerëz të shërbimit informativ.

S.B. Por kurrë nuk është thënë civil.

D.B. Edhe ju gjithashtu e përmëndët që në rastë se dikush ju pyeste në lidhje me këto raste, atwherë ju atë person do ta drejtonit për në Kleçkë, do ta udhëzonit për në Kleçkë pastaj.

D.B. A ishte...a shërbente Kleçka si pikë grumbullimi gjatë këtyre muajve, qershor-korrik, për këta njerëzit që arestoheshin?

DRAFT TRANSLATION

S.B. Jo, unë nuki.... nuk e di as ku çoheshin, por thjeshtë, une I kam /?orjentu/ për shkak se njerëzit ma ëëë....ma përgjegjës mendoja se janë në Kleçkë, për këto çështje.

D.B. Thjeshtë për faktin se Kleçka ishte ëëë...si të thuash, pikë komanduese për ju?

S.B. Po faktikusht aty unë marrnja udhëzimet prej komandant "Çelikut"

D.B. A dini ndonjë prej vendndodhjeve ku njerëzit që janë arestuar pastaj I kanë ...I kanë çuar atje?

D.B. Pasi...sigurisht pasi janë larguar nga Kleçka, pasi kanë ....

S.B. Po ato që janë folë nëpër gjithë ushtarët që e kanë ditë, madje e ka dit edhe popullata...

D.B. Dhe Llapushniku ishte njëra prej këtyre vendndodhjeve? Është e saktë?

S.B. Po Llapushniku....Llapushniku është përmend përgjithmonë në kuptimin se jane ëëëë...janë ndalu njerëzit. Ndalohen dhe po lëshohen. Unë kam pas rastin t'i, përcjell edhe njerëz që janë lëshu prej Llapushnikut...

D.B: Ju keni përcjellë njerëz për n'shpi...?

S.B. Une kam përcjellë njerëz për në ship.

D.B. Njerëz te leshuar...të liruar prej Llapushnikut?

S.B. Po. Do që janë ndalu, janë marr n'pytje dhe janë liru...

D.B. Kështu që ishte një kamp...ka ekzistuar një kamp në Llapushnik ku shqiptarët edhe sërbët janë mbajtur do të thotë?

S.B. S'mund t'a precizoj si kamp se...

D.B.Po ëëë...një...një vendndodhje atëherë?

S.B. Ëëëë....Vendndodhje zakonisht, së paku si m' jan interpretuar mua apo si kam mujt mi kap une, ëëë...ata njerëz kanë ndejt në të njejtin vend, në të njejtin obor.

DRAFT TRANSLATION

S.B. Siç po rri une këtu, tjerët kan nejt ne tjetrin vend edhe aty nuk ka mund t'ket as kamp as...as

S.B. Se ka qen teritor shumë I ...I kufizum

S.B./e pa kuptueshme/ kan ndejt në t'njejtin vend ku kanë ndejt edhe ushtarët, vetëm në shpija të ndryshme..

D.B. Në Llapushnik?

S.B. Në Llapushnik. Ashtu së paku më është interpretuar mua.

S.B. Unë s'mund t'a definoj as si kamp, as si burg, s'po di as ....si ta definoj.

D.B. Një vend do të themi.

S.B. /e pakuptueshme/

D.B. E kam vulosur videokasetën edhe ...

D.B. Ju lutem nëshkuani këtu te kjo pjesa e bardhë.

S.B. Këtu?

D.B. Te kjo pjesa e bardhë.

D.B. Ëëë...Zoti BUJA, ne e dimë që ju e keni vizituar këtë...këtë ëëë...fermë I thonë këta, do të thotë, këtë obor ose këtë ambijent, si I themi ne në shqip, që ju shërbente si qendër ndalimi.

D.B.Gjatë kësaj periudhe, qershor-korrik '98.

D.B. A mund të na I përshkruani rrethanat e vizitës suaj në...në këtë vend?

S.B. Po.

S.B.Faktikisht une kam shku në vizitë në Llapushnik, në komandën e Llapushnikut, të pikës të Llapushnikut

S.B. dhe kur fola, në çet t'njejtin obor kanë qenë edhe

S.B. ato që kanë qenë, të dy vendet, kanë qen në të njejtin obor, e unë s'kam mund as ta precizoj se....

DRAFT TRANSLATION

D.B. Kanë qënq dy vende në të njejtin obor?

S.B. N'të njejtin obor, dy shtëpi

S.B. Edhe une kam shku te...te komandanti do të thotë aty

S.B. /?Edhe/ te "Voglushi"

S.B. Kam shku për një arsye.

S.B. Sepse më është ardhë prindi I nji njeriut I ciliishte ndalu,

S.B. ...ëëë...I cili ishte edhe I njohur I imi

S.B. Edhe, kam sqaru se ai njeri ëëë....faktikisht nuk mund të jetë bashkëpuntor ose kolaboracionist

S.B. Faktikisht ishte ardh baba I tij I cili ishte mjaft I shqetësum

D.B. Baba I tij ka ardh te ju?

S.B: Baba I tij, po.

S.B. /?n'ilin/ kisha respekt.

S.B. Edhe, në qoftë se mund të mirret ashtu, unë kam shku në cilësinë e dëshmitarit për t'a liru atë njeri

S.B.Sepse nuk kasha qasje se a merren n'pytje, a ëëë....si merren n'pytje, a maltretohen a s'maltretohen

S.B. Dhe ka qenë mjaft rrezik edhe pse kam...edhe pse unë kam shku.

D.B Edhe për...edhe vetë për ju?

S.B. Mirëpo, n'pytjet që i kanë bë pasi e kanë liru, se e kanë liru...

S.B. Së paku mue më ka thënë se s'e kanë maltretu

S.B. Dhe e kam çu deri te prindi I tij

S.B. Edhe është lirue. Ai sot është gjallë, mirë, shnosh.

DRAFT TRANSLATION

S.B. Faktikisht me… ëëëë…me u sqaru këto çështje apo këto raste, që unë s'mund t'I mbaj mend as me rend, por mjaft, mjaft shumë, po edhe kjo ndoshta ka ndiku që unë t'jem pak i….

D.B. Që keni ndikuar ju në këto çështje, në këto raste, apo…?

S.B. Po, n'raste kur I kam njoft. Ëëë….ka ndodh…më falni,….ka ndodh që të arestohet njeriu nga ushtarë që nuk ke mund me precizu se kush, por t'arestohet njeriu gabim

S.B. E për ato raste që unë I kam njoft

S.B. …që më kan çitë shpesh në pozita t'kqija,

S.B. Edhe unë së paku I kam informu që "ky njeri nuk mund t'jet kështu ose kështu".

S.B.Ka qenë edhe një…edhe një arsye tjetër.

D.B. There was another reason I want to mention.

S.B. Edhe unë, do të thotë, faktikisht e kam pas shumë vështirë ta njof…t'I njof njerëzit n'komunë t'Lipjanit apo n'komuna tjera.

S.B. Përshkak se shumë I ri kam ra n'burg,

S.B. Shumë një periudhë të shkurtë, kur jam liru, kam ndejt n'KosovëSpeaking

S.B. Kam ndejt n'Zvicër një kohë,

S.B.Edhe kur jam kthy, faktikisht është kon vështirë për mu unë mi njoft njerëzit.

S.B. Por përshkrimi I gjithë asaj është, kam pa dy shtëpi, madje edhe tjetrën që ka qen si shtallë ëëë…ku kanë hongër bukë ushtarët…

S.B. Unë kam ndejt n'ko…komandë aty si /e pakuptueshme/ dhe është ardh aj njeri që ka qen I ndalum n'komandë.

D.B. Cili është ky ëëë… djalë I ri që e ndihmuat për…për ta liruar nga burgu?

S.B. Nuk ishte edhe ai I ri shumë. Ishte dikun 35 apo 40 vjeçar

S.B. Është afër fshatit tim. Ne I thojm te Hani



DRAFT TRANSLATION

S.B. Djali I Haxhës I kam thënë unë gjithmonë se çashtu e kemi njoft ato, djali I Haxhës se s'mund t'a kujtoj emrin e saktë të tij.

D.B. A ti i thërret atij djali I axhës a?

S.B. Jo, djali I Haxhës. Haxhë e ka emrin baba i tij.

S.B. Haxhë.

S.B. Haxha, jo me "O". Haxha.

D.B Hoxha.

S.B. Haxha, me "A".

D.B. A e mbani mënd emrin e tij?

S.B. Ëëë...është vështirë tash ta kujtoj. Ndoshta e kujtoj por është pak ëëë...

S.B. Mduket janë tre-katër vllazën. Aty jetojnë. I kanë shpijat e ëëë...

D.B. Po emrin e familjes...mbiemrin si e kanë?

S.B. Jaaa...s'muj me...me e kujtu, por mund t'ua sjell nji ditë tjetër, emrin dhe mbiemrin e tij. /e pakuptueshme/ m'ka dalë nga mendja.

D.B. Nuk...nuk e mbani mënd emrin ?

S.B. Ja, ja, ja. S'po muj mu kujtu tash sei ...bile para dy-tre dite ...jam

S.B: ...taku, kështu e kam pa.

S.B. N'qoftë se m'kujtohet në ndërkohë, ja u them.

D.B. Pse erdhi...pse erdhi babai I tij te ju për...për të kërkuar këtë punën e lirimit, do të thotë, cila ishte arsyeja që e shtiu atë që të vinte tek ju?

S.B. Fatmirësisht që ne ishim afër dhe njiheshim si familje me ta

S.B. Dhe fshati Buja me shpijat e tyre janë shumë afër, vetëm asfallti I ndan.

S.B. Edhe aryja pse shkova unë, rrezikova, ishte se ai më tha "në qoftë se djali im është bashkëpunëtor I Sërbisë, unë vet e vras".

DRAFT TRANSLATION

S.B. Edhe më tha "ti /e pakuptueshme/ na njeh si familje që s'jemi bashkëpunëtorë të Sërbisë.

S.B. Do të thotë se ajo ishte arsyeja më shumë, se ma njifte babën, ma njifte...

D.B. Kështu që ky ëëëë....ai personi që mbahej nuk ishte ëëë....nuk ishte bashkëpunëtor I sërbëve.

S.B. Jo, jo.

D.B. Kështu që ka pasur raste të UÇK-së që I ka arestuar njerëz që edhe nuk kanë qënë bashkëpunëtorë të sërbëve?

S.B. Shiqo, ky edhe I ka provoke pak në arestim.

S.B. Faktikisht, ka pas do adresa t'sërbëve...

S.B. ...dhe ata kanë dyshu.

S.B. Domethënë, faktikisht une kam shku kam verifiku se ai është njeri I mirë dhe I familjes mirë. Domethënë, s'ka nevojë m'i marr npytje

D.B. Por ky...ky shembull e tregon që UÇK-ja...ka pasur raste kur UÇK-ja edhe ka arestuar njerëz që nuk kanë qënë bashkëpunëtorë të...të...

S.B. Po n'qoftë se ka dyshu....n'qoftë se ka dyshu, e kanë ndalu, e kanë marrë, e kanë verifiku,

S.B. pastaj ka mujt...n'qoftë se s'ka qen ëëë...bashkëpunëtor e kanë lëshu. Unë kam pas raste që i kam prit edhe I kam përcjell njerzt, /?s' është ky/...

D.B. Unë nuk e di për cilin po...po...rast po flisni ju, do të thotë, për këtë që e keni ndihmuar të lirohet ose për ndonjë rast tjetër, por gjatë kohës që ju keni qënë atje në...në kamp, ëëë...I pranishëm ka qënë edhe komandant Çeliku.

S.B. Jo, jo.

S.B. Jo. Unë kam qen ëëë...me dy ushtarë më duket, dy ushtarë

D.B. Dy ushtarë të juaj apo dy ushtarë që I keni gjetur atje?

DRAFT TRANSLATION

S.B. Jo, jo, Dy ushtarë t' mit.

S.B. Edhe komandant Çeliku nuk ka qen aty.

S.B. Domethënë, kam shku n'Llapushnik, e kam taku "Vogëlushin", "Qerqizin", dy-tre ushtarë tjerë më vonë që I kam njoftë...

S.B. Thjeshtë, me Çelikun, me Fatmirin, une nuk kam...nuk kam shku ndonjwherë n'Llapushnik.

D.B. Jo, nuk thash këtë, por ai ishte...ishte I pranishëm në kohën që ju...që ju...ju shkuat atje, që ju...që ju ishit atje.

S.B. Jo. Jo. N'Llapushnik s'ka qenë.

D.B. A jeni I sigurtë për këtë fakt?

S.B. I sigurt jam. I sigurtë. S'ka qenë.

D.B. Sa...sa herë keni shkuar në Llapushnik sipas ëëë....kujtesës suaj?

S.B. Ëëë....n'Llapushnik.. ..n'Llapushnik si fshat, ka qen aty si...unë kam mujt me shku në pjesën tjetër...

S.B. /e pakuptueshme/ ...te komanda.

D.B. Ju mund tu përgjigjeni pyetjeve në rastë se dëshironi Llapushniku si fshat dhe pastaj Llapushniku si vendi për të cilin ne po flasim

S.B. Në...n'Llapushnik te komanda, faktikisht kam shku ç'atë herë. Edhe, nëse...nëse s'kam ...s'gaboj, kam qen afër 15 minuta diku, për amblema të UÇK-së, sepse isha në kalim aty

D.B. Po kështu te komanda keni shkuar vetëm një herë?

S.B. Ç'at herë kam shku te komanda edhe një herë kam qen për emblema, për me marr do amblema që I qëndisshin /?vajzat/.

D.B. Po këto amblemat po te komanda apo në vënd tjetër?

DRAFT TRANSLATION

S.B. Ëëëë...nuk ka qenë komanda aty, faktikisht ka qen një ship tjetër. Mund edhe ka qen edhe komanda por faktikisht n'shpi tjetër jam shku e I kam...I kam marr /e pakuptueshme/

S.B. Ndërsa në...tash a është Llapushnik a është tjetër fshat ain ë afërsi, ëëë...aty kam shku, kam taku ushtarë, se kam lëviz me...me xhip, kur isha...

S.B. Kur e kam taku vëllaun tim.

D.B. Aty ke qen...aty ka pas ushtarë në atë vënd?

S.B: Ka pas ushtarë...

S.B. Ku kam taku vëllaun tim

S.B. ...të madhin, I cili isht ardh n'vizitë te Jakup Krasniqi.

S.B. Po nuk e di a quhet Llapushnik ajo...ajo shpija, apo tjetër fshat.

D.B. Po flasim për Llapushnikun, për vendin ku mbaheshin të burgosurit

D.B. Ju thatë që në të njejtën vendndodhje kishte edhe ushtarë të UÇK-së

S.B. /e pakuptueshme/

D.B. Edhe ju na thatë më parë që në kuadër të këtij organizimi që një nga ato nënnjësitë ose nënpikat quhej Çeliku tre.

D.B. E kjo Çeliku...njësia Çeliku që emërtohej atje ishte edhe e vendosur, e stacionuar në...në atë vendndodhje të cilën po na e....per t'cilën I referoheni

S.B. Po do të thotë, ishte e ndame si e përshkrujta te zona, ëëë....n'rrugë ka qenë, do të thotë Pejë-Prishtinë. "Çeliku Tre" ka qen n' pjesën kah Kleçka këndej edhe...

S.B. Ndërsa n'pjesën tjetër ku ka qen "Guri Tre" faktikisht është dasht ëëë...t'kem ndonjë leje speciale për me dal

S.B. Sepse kan mujt mem arestu mu.



DRAFT TRANSLATION

D.B. Ajo që Zoti Keli dëshironte t'ju pyeste ishte, ne po e quajmë shtab, ju e quani pikë, se s'ka rëndësi kjo, po do të thotë që ëëë....baza ose pika e njësisë tre ishte ....e Çelikut Tre" ishte tek ai vënd, tek ajo vendndodhje po themi ku mbaheshin njerëzit.

S.B. Aty duhet, po une nuk kam shku. Aty kan qen, tash,s unë si I kam pa po flas, nuk mund të ëëë...

S.B. Unë nuk mund t'them se aty ka qen komanda.

S.B. Unë faktikisht kam shku aty, e kam pa njerz që kan qen, Voglushin, Qerqizin...

S.B. Edhe faktikisht unë ëëë....realisht me fol, unë nuk muj me thënë komanda është. Vetëm mund të bi në pozitë t'keqe, pse nuk e di ate.

D.B. Jo po thotë ëëë...a...a e patët mendimin ju ose a e kishit idenë që kjo ishte le të themi komanda ose vendkomanda për...për njësinë "Çeliku Tre" ose për nënpikën "Çeliku Tre"?

S.B. Po, sepse unë kam shku, kam kërku do të thotë komandën e Çelikut tre.

S.B. Edhe m'kanë çu ushtarët. Tash sa ka qen ajo...

D.B. Ky ishte po vendndodhja që flasim, aty ku mbaheshin të burgosurit?

S.B. " Çeliku Tre".

D.B. Le ta quajmë vend ose kamp sit ë dëshironi, nuk ka rëndësi kjo, herët që e vizituat.

D.B. Këto raste të vizitave tuaja kanë qënë nëëë....gjatë kësaj periudhës së ofenzivës së parë, do të thotë, qershor-korrik '98 ?

S.B. T"them qershori, sepse n'korrik pastaj edhe...edhe me pas dasht s'ën kena shku.

D.B. Këtu?

D.B. Kush ishte ëëë....kush ishte përgjegjës, kush ishte në përgjëgjësi për atë vënd, do të thotë për ...për këtë vënd?

DRAFT TRANSLATION

S.B. Gjithmonë kanë qen dualiste /e pakuptueshme/. Dikush ka thënë që është "Voglushi",

S.B. ...dikush "Qerqizi".

S.B. Faktikisht, unë kam kontaktu ma shumë me "Voglushin".

S.B. Për shkak të lidhjeve shumë të forta 'Qerqizi" me "Luanin"

D.B. Për shkak të lidhjeve...?

S.B. "Qerqizi" me "Luanin...

D.B. ...ëëë...kishin lidhje të forta me....me...me...

S.B. Mes veti.

D.B. Me njëri tjetrin?

S.B. Me njëri tjetrin.

D.B. Kështu që juve ishit më në kontakt me "Vogëlushin"

S.B. Me "Voglushin" për shkak të problemeve të mija...me...me

S.B:...me "Luanin" edhe "Qerqizin".

D.B. Kur ëëë...kur përmëndni emrin "Qerqizi", për cilin person e keni fjalën?

S.B. "Qerqizi" do të thotë është fjala për personin të cilin e kam pas më vonë në zonën operative të Nerodimes.

S.B. Është Isak MUSLIU

S.B. Edhe emrin e tij ja kam mësu pas lufte.

D.B. Po emrin e vërtetë të "Vogëlushit" e mbani mënd?

S.B. Po.

D.B. A e dini? Se ishte... pyetja ishte a e dini.

S.B. E di, e di.

S.B. Sepse faktikisht ai ka ra me gjith top në pikën e Llapushnikut

S.B. ...a e kam...e kam mësu poashtu mas luftës si dëshmor.

DRAFT TRANSLATION

S.B. Ai ka qen shumë I gjatë /e pakuptueshme/ "Voglushi".

D.B. Për arsye të incizimit, a mund t'a përmëndni emrin e tij?

S.B.. Të "Vogëlushit" a? Ymer ALUSHANI.

D.B. Do të thotë ju ideja...ose ju patët mbresën ose patët përshtypjen që "Vogëlushi" dhe "Qerqizi" ishin si dy personat përgjegjës për pikën "Çeliku Tre" ?

S.B. Ëëë...ma shumë kam pas përshtypjen se ëëë...e ka "Vogëlushi", se ishte më përgjegjës, ma autoritativ faktikisht.

S.B. Sepse faktikisht "Vogëlushi" e ka lëshu personin që e kam kërku unë.

D.B. Kur...kur keni shkuar në këtë vënd, a jeni ndesh me rojat e këti vëndi, për momentin po I them burgu?.

S.B. Ëëë....

D.B. Keni hasë ne rojet?

S.B. Rrojet e ushtarëve, do të thotë, kanë qenë normale si çdokund. Në rastë se ke shku ëëë...domethënë rreth pikave, t'kanë ndalë ushtarët.

D.B. Ushtarët e ruanin do të thotë vendin apo pikën, aty te porta? Ishin ushtarë ata që kryenin...që kryenin roje...

S.B. Po.

D.B: ...në shërbimin e rojes?

D.B. A njihnit ndonjë prej rojeve?

S.B. Ëëë...s'muj, sa ushtarë kanë...Speaking

S.B. Edhe ata janë ndërru. S'ke pas mundësi....

D.B. Për arsye të incizimit...

D.B. Për arsye të incizimit po u tregoj një fotografi me...e numërtuar U0332456.

D.B. Edhe do tu kërkoj Zoti BUJA në rastë se ju e ëëë...e njihni këtë..këtë vend.

DRAFT TRANSLATION

S.B. Është ndryshim shumë I madh në kohën e...atwherë nuk ka pas...unë /?qysh me thën/, shpija që kam qen nuk ka qen dykatëshe.

D.B. Po a mund t'a përcaktoni se ky ka qënë obori, do të thotë I asaj ferme

S.B. Jo, ka qen ma...ma n'mal dyqysh, tash është mali knej...

S.B. Nuk muj përshkak edhe të fushës koh...

D.B. Kjo është rruga edhe porta për me hy n'oborin kryesor është kjo.

S.B. /e pakuptueshme/ se unë nuk jam shku rrugës faktikisht. Nuk kam pas rastin të shkoj rrugës, se xhipin e kam lën te ëëë...këto therrat /e pakuptueshme/ edhe unëkam shku krejt dika tjetër, do të thotë, sigurisht

S.B. Unë kam hec bukur shumë n'kam, diku pes minuta-dhet /?nashta jon kon/.

D.B. Kjo...kjo foto është bërë pas lufte, kjo fotografi

D.B. Kështu që mund të ketë ndryshime në...në pikëpamje t'shpive edhe....

S.B. Mund të ndodhje për shkak se kjo...se une me than e njof pak a shumë terenin edhe natyrën...

S.B. Njwherë kur kam qënë, atë herën e parë, ëëë...ka qen tjetër ship.

S.B. Ku I kam marr amblemat ka qen krejt tjetër shpi

S.B. Mirëpo, vendi I komandës nuk ëëë...nuk e besoj që është dukë kështu.

S.B. Kjo shpi do të thotë s'ka qenë. Ka qenë një ship dy katëshe, ka qenë një...një tjetër ship që faktikisht m'kanë tregu, m'kanë thënë "çeknej janë ata zotnit", bash kështu m'kanë thënë

S.B. Dhe m'kanë thënë "këtu ushqehen ushtarët". Do të thotë, ai ka qenë një obor, nuk kanë qeën të ndame.

D.B. Për cilin vend kanë thënë "këtu ushqehen ushtarët"? Te kjo dy...te ajo dykatëshja?

S.B. Jo, jo. Një katëshe. Trijat kanë qenë një katëshe

DRAFT TRANSLATION

D.B. Kanë qënë dy…dy □hip njëkatëshe?

S.B. Do të thotë, shpija ku kam hy unë ka qenë njikatëshe,

D.B. Ka qen një katëshe?

S.B. Poashtu ka qenë kuzhina një katëshe,

D.B. Kuzhina ishte e veçantë?

S.B. Kuzhina e veçantë, e veçantë, por nuk ka qenë shpi. Faktikisht, sa më kujtohet….

S.B. Mund…mund të ketë qenë ndonjë ….ndonjë shupë e adaptume apo… s'po di si me qujt. Faktikisht, unë…unë si I mbaj mend, se me njëherë është shumë vështirë me mbajt mend.

S.B. Vetëm në rastë se jane bë ndryshime shumë të mdhaja.

D.B. I kam …I kam përmënd vetëm dy unë, do të thotë, tashti shpija njëkatëshe ky ke hyrë, kuzhina dy….

S.B. Shpija njëkatëshe, kuzhina, edhe një ship që më kanë thënë "këtu janë ata zotnit"

S.B. E gjitha ka qenë në një obor.

D.B. Do t'ju tregoj…tash do t'ju tregoj të njejtën foto tëp o këtij obori.

D.B. Një foto të ndryshme të këtij obori.

D.B. Edhe në këtë foto do të thotë porta gjendet këtu edhe ajo shpija dykatëshe që e shikonit përballë në foton e parë, është këtu, ndodhet këtu.

S.B. Kjo duket ma e afërt.

S.B. Më duket ma e afërt.

S.B. Edhe ju duhet të keni parasysh se s'ën them "është kjo"

S.B. Se unë n'Llapushnik ka qënë hera e parë në jetën time që kam hyrë atë ditë.

S.B. Edhe unë s'kam mujt me …

S.B. Por, më e afërt është kjo.

D.B. Për arsye të incizimit….



DRAFT TRANSLATION

D.B. Për arsye të incizimit, numri I foto...I fotos dy është U0032457.

D.B. Është piktura e të njëjtit obor por nga një ...nga një pozicion tjetër.

D.B. Ju thatë që vizitat që i keni kryer në këtë vënd ishin qershor i '98.

S.B. Qershor. Nuk mund të saktësoj kur.

D.B. Dhe në...në korrik ju nuk e keni vizituar këtë vënd?

S.B. Veç, nuk e di a ka qënë...se mas asaj vizite kam shku për mi marr ato ...amblemat, po faktikisht ka qënë punë natën edhe tash...atje s'muj me përcaktu kurgjë.

D.B. Jun a thatë më parë se ju, ose keni...ose keni ndihmuar vetë personalisht njerëz për tu liruar nga Llapushniku, ose keni hasur, keni ndeshur në /people/...në njerëz që ishin liruar prej Llapushniku.

D.B. A ka raste tjera, do të thotë që ju jeni në dijeni për ëëë...veç rastit të komshisë tuaj që ndihmuat për ta li....për me liruar?

S.B. Po ka raste tjera, po.

D.B. Raste tjera dini, po.

S.B. Që di por edhe që kanë ardhë në fund me...me ...jo me emër por

D.B. Raste, do të thotë, sepse e pyeta, raste që i dini vetë apo thjeshtë si keni qënë pjesmarrës, në kuptimin që keni ndihmuar ose diçka...

S.B. Që I kam pa, do të thotë, kanë ardhë n'drejtim t'Krojmirit, jam taku me ta prej ngat, ose faktikisht ....

S.B. Edhe o dasht me i...me i...në rastë se je taku me një civil....është dasht me dit se kush është.

S.B. Edhe ëëë...n'atë kontakt, une s'kam mujt me mbajt mend kush është, me ja marr t'gjitha gjeneralet edhe me i mbajt në kokë. E kam ndigju, thotë "Prej Llapushnikut", kam qenë i...kam qenë I arestum /e pakuptueshme/"...

DRAFT TRANSLATION

S.B. ...dhe jam lëshu I pafajshëm.

S.B. Faktikisht nuk...nuk muj me majt ato emra mend. Unë tash mund t'ju them "është filani që e di edhe që është... sot është mirë e shnosh", por unë nuk e mbaj mend a ka qenë aj apo aj tjetri.

D.B. A keni pasur disa raste që jeni ndeshur me njerëz që vinin prej andej

S.B. Po, kanë ndodhë dy-tri raste.

S.B. Ky rast është i veçantë, çeky kur kam shku vet m'i marr.

D.B. A mbani mënd, a jeni në gjendje të kujtoni ndonjë prej emrave të këtyre personave që keni ndeshur rrugës ose që keni hasur rrugës?

S.B. Jaa, se është e pamundur...është e pamundur m'i mbajt mend.

S.B. Edhe, t'ju them qartë, n'atë kohë, ne kemi...edhe unë vetë i kam kqyr si njerëz të dyshimtë /e pakuptueshme/.

D.B. Në 25 dhe 26 korrik ka qënë një...një ofenzivë, një sulm i madh mbi Llapushnikun.

D.B. Dhe praktikisht forcat sërbe e kanë pushtuar atë rrethinë, do të thotë atë zonë aty.

D.B. Dhe gjithë vendi, do të thotë aty, është zbrazë, është boshatisë krejt dhe disa të burgosur janë liruar.

D.B. A është e saktë se ju keni hasë, keni ndeshur në njerëz, në një grup të madh njerëzish, që vinin në..në...i keni ndeshë në Krojmir dhe të cilët po transportoheshin ose po lëviznin me një traktor?

S.B. Po, I kam parë.

D.B. A mund ta përshkruani pak këtë situatë?

S.B. Ëëë...nuk më kujtohet mirë, por e di që kam...kam takuar, do të thotë, që në momentet e tërheqjes së popullatës civile...

S.B. ...edhe ka qenë një pshtjellim shumë i madh,

DRAFT TRANSLATION

S.B. ...dhe ëëë...t'ju them të drejtën, kur e kam taku atë traktor,

S.B. Përndryshe, unë kam mendu që janë popullatë civile.

S.B. Edhe më ka bë përshtypje pse gjithë mashkuj.

S.B. E kam ndal traktorin,

S.B. I kam pyt "prej nga ju?"

S.B. Ëëë...m'kanë thënë që "jem nga ëëë...Llapushniku"

S.B. Nga burgu i Llapushnikut, kështu janë shpreh

S.B. Dhe unë...në atë moment jam frenu, s'kam ditë as si t'veproj!

S.B. Ju kam thënë t'presin,

S.B. ...dhe jam këthy ëëë....me ju dhënë me kuptu se po shkoj të marr informacione se si të veprohet me ta.

S.B. Faktikisht jam mundu me... ëëë....me marr lidhje me telefon,

S.B. Fati im i mirë...fati im i mirë ishte që kisha dy të ardhun nga Kleçka,

D.B. Kishe njerëz nga Kleçka aty?

S.B Dy.

S.B. Kishin...

D.B. Në...në Krojmir?

S.B. N'Krojmir.

S.B. Që ishin ardh do nga...t'ikur nga Llapushniku.

S.B. Dhe flitej se ata të ndalum janë liru.

S.B. Faktikisht, nuk e di sa ka shku kohë, kohë ndërmjet asaj që kam dasht mu...mu konsultu...

S.B. Por e di që jam kthy,

S.B. ...dhe ju kam thënë "Ju jeni t'lirum t'shkoni",

S.B. ...dhe një vërrejtje ua kam tërheq.

DRAFT TRANSLATION

S.B. "Se është ofanzivë dhe n'qoftë se shkoni n'drejtim të Lipjanit...",

S.B. ...faktikisht do të bini n'durt e forcave sërbe.

S.B. Këto kanë qenë fjalët dhe nuk kam mund m'i sqaru sepse ka qenë shumë pshtjellim, faktikisht edhe unë e kasha familjen aty, edhe su dike se sip o hec, por e kam dit një që...

S.B. Faktikisht, e kam ditë se në rastë se prej aty shkojnë dhe bijnë n'dorë të forcave sërbe, ata do t'I vrasin.

S.B. Mund të ketë ndonjë detal që s'mund t'a kujtoj, po kështu...kështu gjithmonë si n'mjegull e kujtoj atë rast, pse ka qenë shumë ...shumë....

S.B: Kështu ishte ai takimi me ta edhe....

S.B. Më vonë kam pyetur, sepse gjithmonë më ka ....

S.B....mM'ka shqetësu, do të thotë, ajo mos kam bë gabim...

D.B. Mos ke bërë ti gabim, personalisht?

S.B. Unë mos kam bë gabim.

S.B. Ëëë...faktikisht më kanë thënë "Jo, jo, është n'rregull kjo. Mirë ke vepru".

S.B. Kur kam ndigju, e kam marr si të rezervume këtë, për shkak se krejt m'ikshin., Ikshin prej meje!

D.B. A e mbeni...a e mbani mënd faktin që ata kishin dokumente me vehte, dokumente që provonin do të thotë lirimin e tyre pas burgut?

S.B. S'di. As që e kam kërku dokumentin!

S.B. Nuk...s'besoj që...as që ju kam kërku se s'kam...as s'kam mendu që mund të...mund të lëshohet document edhe prej /e pakuptueshme/ në atë ofanzivë.

D.B. Prej cilit e keni marrë konfirmimin ose informatën se këta njerëz ishin liruar?

S.B. Faktikisht, n'popullatë kanë fol, se konfirmim zyrtar...çato edhe j'u kam frigu shumë se si do ta marrin /e pakuptueshme/.

DRAFT TRANSLATION

D.B. Je friguar shumë për çka?

S.B. Jam friguar për shkak se nuk kam pas një konfirmim zyrtar që është e ...që këta janë liru, do të thotë.

S.B. Edhe, unë i kam liru ata pa ndonjë konfirmim zyrtar.

D.B. Po ju thatë që kur po përpiqeshit të mblidhni informata për këta, ju u përpoqët që të flisnit n'telefon. Me kë...ëëë ...u përpoqët të flisni?

S.B. Kryesisht me...me Kleçkën.

D.B. Por ju nuk mundët me...ëëë...me hy në lidhje me Kleçkën?

S.B. S'kam mujt me kontaktu edhe kam pas edhe shumë arsye që m'kanë /e pakuptueshme/. Faktikisht, unë kam qenë i ëëë...si lloj njeriu i lirë për ato problemet e maherëshme që i ceka.

D.B. Edhe më vonë, ju thatë se më vonë ju përsëri u interesuat dhe u siguruat që ju kishit bërë atë që duhej të bënit, do të thotë, që nuk kishit pasoja prej asaj pune.

S.B. Po, po.

D.B. Po kush ua...kush ua konfirmoi këtë?

S.B. Jakup KRASNIQI, domethënë...faktikisht m'ka thënë që "ke vepru drejtë", se në atë kohë...

S.B. Ëëë...n'fillim do të thotë, e ka marr si diçka provokative,

D.B. E ke marr provokative prej kujt?

S.B. Ai e ka marr.

D.B. Ai e ka marr prej teje provokative?

S.B. Po.

S.B. Po kam kërku mendimin e tyne, se une veç e kisha bë atë veprim. Kam kërku mendimin e tyne për...kur isha veç n'shtab të përgjithshëm, megjithse fillun dyshime hala ma t'mëdhaja.

DRAFT TRANSLATION

S.B. Këto ëëë...edhe këto e kanë ndihmu mjaft shumë dezinformatat që /e pakuptueshme/.

D.B. Dhe, a folët në....a keni folë në ndonjë rast me Çelikun për ...për këtë ngjarje?

S.B. Po, po /e pakuptueshme/.

S.B. Faktikisht, në gjendjen time, unë mundohesha të ëëë....me secilin t'a sqaroj ...punën.

S.B. Edhe Çeliku...faktikisht, nuk di me rezervë apo pa rezervë, por secili...nuk ka qenë asnjëri që m'ka thënë "ke vepru keq".

D.B. Kur...kur keni fol me Çelikun për...për këtë?

S.B. Kjo ka qenë shumë më vonë.

S.B. Sigurisht...sigurisht po them ëëë...pas...pas ëëë....rregullimit apo ëëë...pas vendosjes nëpër gryka, t'popullatës

S.B. Kështu që s'kemi mujt as me bisedu, as kurgjë, se ka qen nji pshtjellim tri-katër ditë, gjatë ofanzivë shumë t'madhe.

D.B. Mendoni që ka qënë punë ditësh apo javësh që keni folur me të?

S.B. Punë...punë ditësh se punë...punë javësh nuk u kon por punë ditësh. Tri-katër ditë, pesë ditë kanë mujt me shku.

D.B. Keni folur kështu në...në prani të njëri tjetrit apo keni folë n'telefon?

S.B. N'prani t'njëri tjetrit.

D.B. Ku...ku e keni takuar që keni folë me të?

S.B. Po... Çelikun, nuk e di ku...ku kemi bisedu për këtë çështje saktë, por e di që kam bisedu...e kam taku n'Luzhnicë, e kam taku n'Kleçkë,

S.B. ...ndoshta e kemi bë...mund të ndodh t'kemi bisedu kur kemi bë rrugën prej Luzhnice deri n'Kleçkë me xhip, se une isha n'Luzhnicë /e pakuptueshme/.

D.B. E çfarë tha ëëë....çfarë ju tha ai për rastin?

S.B. Shumë shkurt, shumë me rezervë m'tha "n'rregull, n'rregull është", edhe...

S.B. Do të thotë, nuk kemi...nuk ka hy... as unë më vonë, edhe pse unë kam sqaru më gjatë, po veç më ka thënë "n'rregull është, n'rregull. S'ka ..."

D.B. Dhe ju ia keni thënë atij faktin që kishit parë ose kishit ndeshur këta njerëz me traktor që vinin prej Llapushnikut?

D.B. Edhe ju ia thatë edhe faktin që kishit lejuar ata t'shkonin më tej?

S.B. Po, po. Unë faktikisht e sqarova sepse isha në pozitë t'keqe.

S.B. "Unë jam kështu, unë i kam liru, mos kam bë diçka keq", tani tha "n'rregull është", /e pakuptueshme/".

D.B. A e keni njoft ndokënd prej personava n'traktor, ndonjërin prej...prej tyre?

S.B. Nuk...nuk mundem absolutisht me kujtu asnjë.

D.B. Po kështu me përafërsi, sa njerëz mund të kenë qënë në atë traktor?

D.B. Më...më shumë se dhjetë, më pak se tridhjetë, po përdorim...

S.B. Jo, nuk ka qënë më shumë se dhjet S'ka mund me qenë.

D.B. Më shumë se dhjetë nuk kanë mund me qen?

S.B. S'kan mund me qenë. Faktikisht, ka qenë me rimorkio traktori.

D.B. Si ishte gjendja e tyre kështu? Në çfarë...n'çarë gjendje ishin?

D.B. Sigurisht fizike e ka fjalën.

D.B. Edhe kështu nga pamja, si...si dukeshin?

S.B. Nga pamja... faktikisht, vetëm se i kam pa se mashkuj, edhe kam...kam dyshu sepse t'gjithë mashkuj /e pakuptueshme/.

S.B. Sepse nuk kam dyshu nga diçka tjetër.

S.B. Edhe ka qenë punë...moment shumë i shkurtë.

S.B. Sepse kishim ofanzivën. S'kisha kohë me nejt edhe me...me .../e pakuptueshme/

S.B. Unë s'kam marr mi kqyr një ka një!

DRAFT TRANSLATION

S.B. ...por e kam marr shoferin, I kam thënë "kush jeni ju, prej ka po vini",

S.B. Kur më ka thënë kështu, i kam thënë "pritni",

S.B. ...edhe kam hec edhe mbas një kohe jam këthy edhe u kam thënë "ecni, po keni kujdes" Aq, nuk ka pas mundësi....

S.B. Tash, s'muj me thënë...gjendja e tyre, ata kan qenë ulë domethënë n'traktor. A ishte ...a kanë /e pakuptueshme/.

S.B. Kështu ka qenë.

D.B.Unë dua të flas tani pak për burgun dhe për...për...për njerëzit të cilët mendoheshin se ishin bashkëpunëtorë t'sërbëve janë mbajtur atje.

D.B. Ja, për shembull, ju na treguat rastin kur ju vetë e dinit, do të thotë kishit dijeni se ai njeri i cili ishte mbajtur ose ndaluar, nuk ishte bashkëpunëtor sërb, ju personalisht ndërhytë për ta liruar personin.

D.B. A dini gjë për faktin që pasi këta njerëz ndaloheshin nën...nën këtë dyshim si bashkëpunëtorë të sërbëve, që kryheshin hetime për ta...për t'a qartësuar pozicionin e tyre...pozitën e tyre, se ishin apo jo bashkëpunëtorë të sërbëve? Do të thotë, a e dini faktin që ...a e dini si fakt këtë që kryheshin hetime për të qartësuar pozitën e tyre si njerëz?

S.B. Nuk ëëë...nuk mund t'precizoj kurgjë faktikisht se ëëë....

S.B. ...edhe në natyrën time me qenë t'mos pys

S.B. Nuk ka qenë...nuk ka qenë puna ime ëëë...n'këtë drejtim. Ku e kam pas punën time, kam dasht me ja precizu.

S.B. Mund të flas çka kanë folë tjerët, por nuk është e ndershme se ...

D.B. Si mendoni për faktin, se ju keni hasur njerëz,,keni ndeshur njerëz të cilët ju i keni pyet që je...kanë ardhë prej Llapushnikut, kanë qënë të ndaluar atje, pastaj kanë

DRAFT TRANSLATION

qënë të ëëë...liruar do të thotë. Do të thotë, që nuk kanë qënë bashkëpunëtorë të sërbëve sipas kësaj ëëë...logjike.

S.B. Po ëëë...n'qoftë se mund të shpreh mendimin, ajo është diçka tjetër.

S.B. Do të thotë, opinioni im atëherë ka qenë, edhe tash është me siguri, se ata nuk kanë qënë bashkëpunëtorë, do të thotë janë liru pikërisht për faktin se s'kanë qenë bashkëpunëtorë.

S.B. Do të thotë, ky ka qenë opinioni atëherë edhe tash. Kur lirohet njëri, lirohet i pafajshëm!

D.B. Do të...do të marrim ne...do të bëjmë një pushim të shkurtër. Nuk ka...nuk ka mbetur edhe shumë. A jeni I kënaqur ose a...a pajtoheni që të vazhdojmë edhe pak më tej?

S.B. Po, pse jo. Po.

S.B. Po ëëë... jam ngarku shumë...ngarku shumë, tan ditën edhe...

D.B. Po ne duam ta kryejmë këtë përfundimisht sot këtë punë edhe që mos...mostë ketë më nevojë për...për intervista tjera.

S.B. N'rregull, n'rregull është. Duhet të keni parasysh se iI kam edhe pesë vjet burgu

S.B. Ndejtja tan ditën mbrenda, do të thotë, tepër e rëndë është.

D.B. Ha, ha. Do të...do të dilni sot thotë.

D.B. Është ora 1417

D.B. ...dhe ne do të bëjmë një pushim të shkurtër.

(BREAK)

S.B. Kesh tu ja marr kimikun.

D.B. Po vjen...po vjen vera, thotë.

S.B. Shumë nxehtë /?sot/.

D.B. Koha sipas orws sime wshtw 1440...

DRAFT TRANSLATION

D.B. ...dhe do të vazhdojmë intervistën me Zotin BUJA.

D.B. Para se të merrnim pushimin, ne po flisnjim për atë që ne, për ti bërë gjërat më..më...më të lehta për tu diskutuar, po flisnjim për atë që e quajtëm burgu n I Llapushnikut.

D.B. Edhe kur them burgu, unë kam parasysh vendin ku...ku njerëzit mbaheshin në Llapushnik.

D.B. Ju thatë se ju realizuat ose ju vutë n'dijeni të faktit se kishte njerëz që u liruan prej...prej këtij vendi, prej burgut.

D.B. A morrët informata ose...ose a ndeshët në informata të...të llojit ëëë...në lidhje me rrethanat se si trajtoheshin njerëzit në këtë vend ku janë mbajt?

S.B. Jo ëëë...nuk...ata që i kam pyt, do të thotë, atë personin të cilin e kam liru, do të thotë që kam intervenu për t'a liru, ai ose nga frika ka thënë ose ka pas drejtë, e nuk e di, sëpaku ai thotë se nuk ëëë...nuk është maltretu. Ndërsa për tjerët, s'mund të...s'mund t'them asgjë sepse...ëëë...nuk kam qenë n'rrjedha t'asaj.

D.B. Në lidhje me personat e tjerë, e kam fjalën për ata që nuk u liruan nga burgu, a dëgjuat për këta persona si...sit ë zhdukur.

S.B. Ëëë...jo, pas luftëm kam dëgju.

D.B. A na...a mund të na thoni çka keni dëgjuar, do të thotë, pas luftës?

S.B. Po. Pas luftës, do të thotë, është folë se "është marr ky, nuk është edhe ai"

S.B. Madje edhe pse I kam lexu emrat tash edhe në aktakuzë, absolutisht s'i mbaj mend emrat.

D.B. Po flasim përsëri për grupin e personave që...që u liruan edhe që i patë duke ardhë me traktor, që vinin prej ëëë...që i patë në Krojmir.

D.B. Ëëë...mbase atë ditë më herët, ose një ditë më parë, ata janë ndarë...janë veçuar prej një grupi tjetër personash,

DRAFT TRANSLATION

D.B. Këta pjesa tjetër, do të thotë, këta që nuk u liruan, janë vrarë.

D.B. Dikush nga ata, do të thotë që mendohen të vrarë, mbijetoi, shpëtoj, por shumë prëj tyre janë vrarë.

D.B. Ne kemi gjetur kufoma dhe disa kufoma...dhe kufomat janë identifikuar

D.B. Dhe një është identifikuar, dhe një prej këtyre rojeve të këtij të ashtuquajturit burg që po e quajmë është identifikuar se një prej rojeve ka qënë një nga...një nga ata që i kanë vrarë këta njerëz.

D.B. Edhe siç e përmëndët edhe ju që I keni lexuar aktakuzën n'lidhje me këtë çështje...

D.B. A keni ndonjë ide ose mendim tuajin se pse janë vrarë këta njerëz, pse mund të jenë vrarë këta njerëz?

S.B. Po nuk ëëë...është vështirë të jap mendime ëëë...për shkak se nuk ëëë...nuk di kush ishin ata njerëz

S.B. Faktikisht, pot ë isha n'rrjedha se kush për çka është marr,

S.B. ...do të thotë, kasha mujt me...me dhan mendimin.

S.B. Mirëpo, thjeshtë, ata emra që I kam lexu,

S.B. ...faktikisht, pas luftës ka pas shumë fjalë,

S.B. ...se kanë qenë bashkëpunëtorë të Sërbisë.

S.B. ...por faktikisht unë nuk mund t'i cilësoj as ashtu, as kështu.

D.B. Po para se...para aktakuzës, a ishte kështu, domethënë e përhapur në...në publik ose në popull ëëë...fakti ose informata ose njohuria që këta njerëz ishin vrarë? Para se të vimë te...te aktakuza zyrtarisht.

S.B. Ëëë...po flitej se domethënë ëëë...faktikisht për shumë emra

S.B. Ëëë...UÇK-ja i ka marr përsipër edhe me komunikatë.

D.B. Që do të thotë...

DRAFT TRANSLATION

S.B. Dhe tash fjalën ëëë....

D.B. Ka marr përsipër përgjegjësinë që ky...

S.B. Përgjegjësinë, po.

D.B. Si bashkëpunëtorë të sërbëve?

S.B. Si bashkëpunëtorë të sërbëve.

S.B. ...dhe ishin normale pastaj fjalët se këta njerëz, si bashkëpunëtorë të Sërbisë do të thotë, i ka vra UÇK-ja.

S.B. Mirëpo, ka edhe raste ekstreme ku ëëë...unë nuk ...nuk e besoj, mund t'jem tepër I gabum, që e ka bë vrasjen UÇK-ja. Ka raste ekstreme do të thotë.

D.B. Raste ekstreme që mund të jenë interpretuar gabim?

S.B. Ekstreme, që mund të ...mund të...t'i ngarkohen UÇK-së që nuk mund t'a besoj.

D.B. M'fal Shukri se pot ë bezdis, po dua që t'a ...t'a vendosësh qartë pohimin, që t'a përkthej qartë

S.B. /e pakuptueshme/ Do të thotë, është fjala për ndonjë rast ekstrem kur unë nuk mund ta besoj sepse ...

D.B Që e ka bërë UÇK-ja atë?

S.B. atë njeri...atë njeri e kam njoft, e kam njoft shembull, dhe s'mund të besoj që e ka vra UÇK-ja. Faktikisht, pas luftës ka shumë dezinformata.

S.B. ëëë...po I marr disa shembuj

S.B. Akuzohemi, si UÇK në përgjithësi, se kemi vra vetë komandantët tonë.

S.B. Do të thotë, nga kjo tu u nis, do të thotë është vështirë me I besu të gjitha ato që plasohen.

S.B. Ëëë...prandaj po them nuk...nuk mund t'flas për ëëë...për ata njerëz për t'cilët nuk kam informacione sepse është shumë reziku i madh.

DRAFT TRANSLATION

D.B. Ju…ju lutem, thotë, vetëm kuptoni një fakt që ëëë…hetimi jonë kryhet I bazuar mbi fakte.

D.B. …dhe këto thashethemet ose fjalët nëpër njerëz vetëm ne mund t'na çojnë tek personi që ne duhet të flasim ose të cilin ne duhet ëëë…me të cilin ne duhet të bisedojmë.

D.B. Do t'ju jap një shembull.

D.B. Nuk është nevoja që të shkojmë rast për rast në atë…në..në listën e atyre personave që i përmendëm, që janë mbajtur në kamp dhe pastaj janë vrarë.

D.B. Një nga personat e vrarë quhej Emin EMINI, nga ëëë…nga personat e vrarë.

D.B. A..a ju kujtohet si emër?

S.B. Jo.

S.B. Ëëë…mund t'a kujtoj si emër n'qoftë se është n'aktakuzë, do të thotë, edhe pse ashtu kështu s'po m'kujtohet.

D.B. Vëllau i tij ishte ushtar me UÇK-në….

D.B. …dhe vëllau i tij u lajmërua në Krojmir, në Maj '98, do të thotë, për t'u bashkuar me UÇK-në.

D.B. Shtëpia e tij, e babës tij, në Carralevë është përdorur shumë herë prej ushtarëve të UÇK-së.

D.B. Edhe unë do të habitesha në rastë se ju nuk do të…nuk do të kishit njohuri mbi…mbi…mbi shtëpinë e Idriz Muharremit.

D.B. E e njeh…a e njihni Idriz Muharremin?

S.B. Ëëë…mund t'a kujtoj ndoshta si figurë aman s'po më…si emër nuk e kujtoj.

D.B. Ky është...ky është një rast, po ua solla si…si shembull që duke qënë përkrahës të UÇK-së, do të thotë, vëllau i tij ishte ushtar I UÇK-së dhe vëllai tjetër i tij u…u vra.

DRAFT TRANSLATION

D.B. Edhe, vëllai i tij, do të thotë, vëllai I këtij ushtarit të UÇK-së, e kanë çuar në Llapushnik edhe gjatë...gjatë www...ndalimit, gjatë arestimit tij atje e kanë rrah keq.

D.B. Dhe në fund ai sigurisht ...në fund e kanë vrarë.

D.B. Dhe nuk është dhënë asnjë arsye për...për...për vrasjen pse.

S.B. Ëëë...pikërisht këtu...edhe u nisa unë nga kjo. Për mu është jasht logjikës...jasht logjikës kur vëllau n'UÇK, vëllau tjetër i vramë nga UÇK-ja! Ëëë...

S.B. Prandaj unë s'ën...s'ën flas për këto raste.

S.B. Ëëë...do të thotë, këto...këto raste janë shumë t'rënda

S.B. Edhe madje ëëë...do t'ishte dëshira ime, po edhe e kësaj popullatës sigurisht, të mos marr ate përgjegjësi me folë n'emër popullatës, që vërtetë të sqarohen këto.

S.B. Edhe, nuk muj m'I marr me mend motivet.

S.B. Ndoshta një rrugë e tillë ka qenë të /?dështoj/ edhe unë.

D.B. Në...në çfarë mënyre?

S.B. Një rrugë e tillë do të thotë, pas shumë dezinformatav dhe akuzash që kanë bë, t'më vrasin një ditë dhe të thonë ka qenë bashkëpunëtor...

S.B. Mirëpo, është diçka tjetër fati im, diçka tjetër fati I dikujt tjetër.

S.B. Për atë, s'po muj...s'mundem....

D.B. Dua t'ju bëj disa pyetje lidhur me një çështje, temë tjetër.

D.B. Përsëri po flasim për periudhën kohore maj, qershor, korrik '98.

D.B. Çfarë dini për policinë ushtarake në atë kohën që ju keni qënë aktiv në...në zonën tuaj. Do të thotë, në zonën...më fal, që ka qënë aktive në zonën ku keni qënë...ku ndodheshit ju?

S.B. Faktikisht, n'atë periudhë, ne...ne s'kemi ditë për policinë ushtarake

S.B. Diku rreth qershorit.

S.B. ...ëëë...kam parë, faktikisht në atë territor, dy polic ushtarak.

DRAFT TRANSLATION

S.B. Më vonë, diku n'korrik apo ...nuk mund t'a qartësoj mirë kohën, kanë fillu organizimet e policisë ushtarake.

S.B. Por gushti është sigurisht periudha kur ka fillu organizimi i qartë i policisë ushtarake.

D.B. Si i keni njoft që kanë qënë t'policisë ushtarake kur i keni parë në qershor ata dy personat?

S.B. Po ëëë...zakonisht, policisë ushtarake në fillim u kanë, qysh edhe ma vonë është vepru, por n' fillim vetëm është shkru ajo "polici ushtarake"

D.B. A kishin uniforma të veçanta?

S.B. ëëë...jo ndonjë uniformë t'veçantë, se I kanë shfrytëzu edhe uniformat ushtarake, kanë pas edhe uniforma t'zeza ndonjëherë.

S.B. Besa pas korrikut, do të thotë, gusht, shtator edhe më vonë, ka fillu të definohet uniforma e policisë ushtarake.

D.B. Çfarë...çfarë uniforme u përcaktua më vonë për ta?

S.B. Kryesisht e zezë ka qenë.

D.B. Kur I keni parë së pari këta dy...personelin e policisë ushtarake, oficerë të policisë ushtarake, a kishit dijeni çfarë detyrash kryenin në fakt?

S.B. Ëëë...po në fillim mu m'është thënë se policia ushtarake do të mirret me ëëë...me ëëë...ushtarët do të thotë. Faktikisht se ushtarët mund t'ikshin nga vija e frontit dhe po...

D.B.Me e këqyr sjelljen e ushtarëve, ë?

S.B. Sjelljen e ushtarëve.

S.B. Mirëpo, definim t'përgjegjësisë nuk ka pas n'atë periudhë.

S.B. Më vonë janë definu.

DRAFT TRANSLATION

D.B. Porn ë...po flasim përsëri për verën e '98. Amund...a mund të thoni se ata ishin nën autoritetin e komandës së Kleçkës?

S.B. Tash ata...dy policë që kanë qenë në...në atë pjesën ku vepronin, n'Shalë, Krojmir, Petrashticë, ata dy policë zakonisht kanë ardhë, janë konsultu aty, qoftë me "Luanin", qoftë me mu, qoftë kanë shku n'Kleçkë, do të thotë, ka qenë thjeshtë ëëë...punë e tyne pa...pa ndonjë definim t'plotë.

S.B. As vetë ata nuk e kanë dit se çka bëjnë.

D.B. Por në rastë se e shtrojmë...e shtrojmë çështjen në..në këtë pikë, kur ata kishin për të raportuar diçka, ata do të...do ti raportonin Çelikut apo do t'u raportonin tek ju si komandant pike për shembull?

S.B. E jo, te ne nuk ka pas ndonjë raport. Ëëë...zakonisht o shku Kleçk. A ka raportu n'Kleçkë te Çeliku apo ka raportu te Kumanova, a ku ka raportu, faktikisht, ne nuk e kemi ditë.

DRAFT TRANSLATION

D.B. Për te ju, te pika juaj...

S.B. Për te ne, ka mujt me ardh, mu konsultu për diçka dhe...

S.B. ...jo raport, thjeshtë jo raport.

D.B. Kur ju thoni te ne, do të thotë n'Krojmir?

S.B. Te ne n'Krojmir, qoftë n'Petrashticë, mvaret ku kam qenë unë, ku kam...

D.B. Cilin e...?

S.B. "Kumanova"

S.B. Sepse edhe unë s'e kam ditë se çka duhet t'bëjnë ata.

D.B. Ëëë...gjatë takimeve, do të thotë në këtë...gjithsesi në këtë periudhë maj-qershor, në takimet që mund ...mund të keni pasur me Çelikun në kohën kur jepeshin urdhërat ose udhëzimet, ose bëheshin konsultimet, a ëëë...a përmëndej ky ëëë...policia ushtarake si polici ushtarake ...gjatë...gjatë takimeve?

S.B. Ëëë...nuk di që t'kemi bisedu për ndonji fushë t'veçantë, do të thotë si policia ushtarake, po e di që një problem që m'ka ndodh mu drejtpërdrejtë me policinë...policinë ushtarake ka qenë se ëëë...faktikisht kanë mendu, ata n'Krojmir, ai rrethi, klani që /e pakuptueshme/, ëëë...se unë kam caktu një polic ushtarak nga fshati im.

S.B. Dhe kam...n'ate kohë e di që ja kam sqaru Çelikut se absolutisht s'kam pas as ide se çka është polici...policia ushtarake!

S.B. Dhe e di që aty është sqaru që do të caktohen policia ushtarake. Dy...dy do të caktohen, dy polic ushtarak n'atë teren.

S.B. Faktikisht, unë as që e kam pas shumë të drejtën të përzihem n'këtë.

D.B. Ëëë...kur na e përmëndët ëëë...atë rastin, në rastet kur njerëzit arestoheshin dhe ëëë...vinin te ju për të kërkuar mendim ose se si të veprojë, atëherë ju i drejtonit ata për në Kleçkë.

D.B. Edhe unë po përpiqem të sqarojë nëse...nëse policia ushtarake kishte ndonjë...ndonjëfarë roli ose detyrë për arestimin e këtyre, do të thotë, për arestimin e njerëzve, në rastet kur kryheshin arestimet.

S.B. Jo. N'atë kohë, jo.

S.B. Faktikisht, dy policë kanë qenë.

D.B. Kështu që, nuk kishte urdhëra të qartë për ju se si...si të veprohej me policinë ushtarake?

DRAFT TRANSLATION

D.B. Kështu që, nuk kishte urdhëra të qartë për ju se si...si të veprohej me policinë ushtarake?

S.B. Jo.

D.B. Jemi...jemi pothuajse...jemi në përfundim t'intervistës.

D.B. Kemi...ju kemi pyetur ...ju kemi bërë gjithë ato pyetje...

D.B. ... Gjithë këto pyetje që kanë lidhje me këtë periudhën që po flasim, pranverë-verë '98,

D.B. ...në lidhje me këtë zonë,

D.B. ...në lidhje me Lapu...Llapushnikun.

D.B. Ju na i...ju keni folur mbi gjërat që ju vetë i dini dhe mbi gjërat që ju nuk i dini sigurisht.

D.B. A ka ndonjë...një diçka, ndonjë gjë që ju mendoni se është e rëndësishme në lidhje me...sigurisht me të gjitha ato që biseduan, ndonjë gjë që nuk...nuk u...nuk u cek gjatë pyetjeve-përgjigjeve.

D.B. Apo i kemi...i kemi cekur të gjithë pikat e ëëë...e ëëë...që kanë lidhje me këtë çështje?

S.B. Ëëë...besoj se janë prek shumica e çështjeve, edhepse...

S.B. ...edhepse është shumë vështirë të kuptohet ajo periudhë,

S.B. ...forma e organizimit, pshtjellimet n'atë kohë. Është shumë vështirë, por mendoj se ëëë...janë qartësu disa /e pakuptueshme/ .

S.B. Po mendoj se...përgjithësisht do të thotë, janë...janë qartësu, n'qoftë se mund ti kuptoni këto.

S.B. N'qoftë se diçka nuk ëëë...nuk është e qartësume, do të thotë unë jam i gatshëm kur t'më thoni të vijë dhe t'a qartësoj aq sa ..sa /?kam mundësi/.

D.B. Kjo...kjo praktikisht çon në pyetjen tjetër që kam unë për ju.

DRAFT TRANSLATION

D.B. Në...në rastë se do të vinte nevoja ose do të ishte rasti që ju do të thirreshit...do të ftoheshit si dëshmimtar n'Hagë, a do të ishti ju i gatshëm, a do të kishit dëshirë që t'ja thoshit trupit gjykues të gjitha këto që na...që na i treguat sot?

S.B. Po pozicioni I dëshmitarit është pak sa i vështirë.

S.B. Ëëë...mirëpo, këtë që i deklarova këtu,

S.B. ëëë...do të thotë, deklaroj hapur edhe , pa ndonjë /e pakuptueshme/.

S.B. Mirëpo, ëëë...duhet t'a kuptoni edhe një...një gjë tjetër, që /?une mos t'bie/ nw pozita të këqija

S.B. Vetë cilësimi si dëshmitar kundër ëëë...njerëzve me të cilët kam luftu është pozicion që më çet n'pozita shumë t'kqija.

S.B. Mirëpo, unë jam i gatshëm, në çdo moment,

S.B. ëëë...sepse jam përcaktu që t'jem shumë transparent edhe i hapur

S.B. Ëëë...edhe, besoj se nuk do t'më pengoj t'vijë edhe atje

S.B. ...edhe të dëshmoj të cilat i dëshmova tash.

S.B. ...edhe e thash vetwm me nji shkak, qw thjeshtw, unw t'mos bij nw pozitw t'keqe.

S.B. /e pakuptueshme/.

D.B. Ky është shkaku që ju dëshironi të vini në Hagë?

S.B. Jo, që nuk...

D.B. Që nuk dëshironi?

S.B. Duhet ...duhet t'keni kujdes sepse...

S.B. Unë fola më herët për mentalitetin shqiptar,

S.B. ...e pavarësisht si paraqitesh në Hagë,

S.B. ...vetë cilësimi dëshmitar në proçesin kundër ëëë.../e pakuptueshme/

S.B. Pavarësisht se çka...çka thuhet /e pakuptueshme/



DRAFT TRANSLATION

S.B. ...se ma tutje nuk shkoj me analizu,

S.B. ...vetëm, m'dëmton shumë.

S.B. Mirëpo, unë ...

S.B. ...unë kërkoj që kësaj t'i ipni sa t'keni mundësi, dhe në momentin kur duhet patjetër...do të thotë, unë do të jem i gatshëm.

D.B. Unë ju kuptoj plotësisht në...në atë që përpiqeni të thoni.

D.B. Do të thotë që ju jeni...ju jeni I gatshëm për t'a bërë atë por do të ishte më mirë që mos...most ë ishte ëëë...mos t'ishte nevoja që të thirreshit.

D.B. Edhe, siç e thatë ju, na këshilluat që ne t'a përdorim atë vetëm si mjet i fundit në rastë se nuk ka asnjë mundësi tjetër.

D.B. Unë e kuptoj këtë.

D.B. Kjo nuk...mund të mos ketë ose mund të ketë të bëj me...me incidentet për të cilat ne folëm...para ca.

D.B. Po dua...dëshiroj t'ju tregoj disa fotografi

D.B. Për...për arsye të incizimit, kjo fotografi është e numërtuar U00332

D.B. 3 9.

D.B. Ëëë...a e mbani mënd ëëë...ku është marr...ku është bërë kjo foto?

S.B. Jo, s'mund t'a mbaj mend. Mund të jet ....s'mund t'a mbaj mend por kjo fotografi e bërë është ose n'shtab të përgjithshëm ose në vizitën që ka bërë ëëë...si anëtarë t'shtabit të përgjithshëm në zonën time.

S.B Faktikisht, mjekra që e kam pas, nuk e kam pas si komandant zone.

D.B. Ju jeni këtu?

S.B. Nuk e di që e kam pas mjekrën, /po/, por e kam pas n'periudhën e parë t'luftimeve.

DRAFT TRANSLATION

D.B.Mendoni se mund të jetë marr kjo fotografi në Krojmir, mund t'jet bërë në Krojmir?

S.B. Jo, kjo s'mund t'jet në Krojmir. S'mund t'jet n'Krojmir, jo.

S.B. Mund t'jet e periudhës pas nëntorit.

D.B. '98?

S.B. '98.

S.B. Ose është n'periudhën, do të thotë kur kam mbri nga...nga Shqipëria, n'kthimin.

D.B. Për arsye t'incizimit, formalisht a mund të na thoni cilët persona I identifikoni në këtë fotografi?

S.B. Po. Normalisht, unë jam këtu;

S.B. ...me syza është fatmir Lima;

S.B. ...n'mes është Hashim Thaçi;

S.B. Këta dy tjerët nuk...

D.B. Çfarë pozite mendoni ju se ka pas Fatmir Limaj në këtë kohë? Në kohën e fotografisë do të thotë.

S.B. Mendoj se ka qenë anëtar I shtabit të përgjithshëm.

S.B. Diku është /nëntori/...

S.B. ...periudha e nëntorit.

D.B. Po pozita e Hashim Thaçit n'atë kohë, në të njejtën kohë?

S.B. Ëëë...n'atë kohë ka qenë ëëë...sigurisht n'drejtorinë politike.

D.B. Por ju nuk e mbani mënd vendin ku është bërë fotoja?

S.B. Jo, s'mundem.

D.B. Pwr arsy tw incizimit www...numwrtimi I fotografiswwshtw

D.B. U0033250.

D.B. A e njihni këtë ushtar në fotografi?

DRAFT TRANSLATION

S.B. Jo, s'di kush është ai.

D.B. Do t'ju tregoj dhe një fotografi.

D.B. Ju sigurisht që I njihni disa njerëz aty, po a mund ta kujtoni se ku...ku mnd të jetë bërë kjo fotografi.

S.B. Ëëë...mund të jet bërë n'Krojmir. Mund të jet bërë se sj'jam i sigurt.

S.B. Po ma shumë ka të ngjarë që është bërë n'Kleçkë.

O.L. Ok you...you...you don't remember the occasion when this picture was taken?

D.B. Nuk e mbani mënd me...në...në çfarë...në çfarë rasti është bërë kjo fotografi ose në çfarë rrethanash?

S.B. Jo, s'mundem.

D.B. A kështu si periudhë kohore, kur mendoni se mund të jetë bërë?

S.B. Ëëë...nuk mund t'a mbaj mënd, do të thotë është e pa mundur për shkak....nga pozitat këtu, do të thotë...të shpisë apo /e pakuptueshme/ duket sikur n'Kleçkë.

S.B. Mirëpo periudhën nuk...

D.B. Për arsye t'incizimit, ju treguam një fotografi e cila nuk është e numërtuar.

D.B. ....por kjo nuk do të jetë provë dokumentuese

D.B. Sepse ëëë...Zoti Buja nuk njeh hollësi mbi fotografinë.

D.B. A mund të shënoni datën dhe t'i nënshkruani të dy këto...?

S.B. Sa është data sot?

D.B. 28 prill.

S.B. Zero...

D.B. Zero katër.

S.B. Katërshi...

O.L. And...and sign, please. Yeah, and...and that one.

S.B. Edhe këtë.

DRAFT TRANSLATION

D.B. Po.

D.B. 28.

S.B. 28...e shkrujta datëlindjen tem, zero katër, dy mijë e dy. Datëlindjen tem faktikisht e shkrujta.

S.B. M'falni që po e kufizoj.

D.B.Dy pyetje formale para se të...t'a përfundojmë intervistën.

D.B. Zoti Buja, a jeni përgjigjur të gjithë pyetjeve sot me...me vullnetin dhe dëshirën tuaj të lirë?

S.B. Po.

D.B. A ju ka kërcnuar ose ju ka premtuar kush diçka për t'ju përgjigjur këtyre pyetjeve?

S.B. Normalisht jo.

D.B. Falemderit që keni ardhur. Shumë falemderit.

D.B. Koha sipas orës sime është 1517.

D.B. Pas kësaj ne do t'a mbyllim zarfën...do t'a mbyllim videokasetën në një zarfë.

D.B. Unë tani po e mbylli intervistën dhe po ndërpres incizimin.

DRAFT TRANSLATION